

# VETERANI

GAZETË PERIODIKE. NR.5(454)

MAJ 2026

ÇMIMI: 30 LEKË

Drejtor: MUHARREM GJOKA; Kryeredaktor: HALIL RAMA ; Zv/Kryeredaktor: SAKIP CAMI; website: www.VETERANIOBVL.ORG

## HISTORIA


**KONGRESI HISTORIK I PËRMETIT NË KUJTIMET E GJENERAL RRAHMAN PARLLAKUT**



FAQE 3

## PERSONALITETE

**FADIL HOXHA, ARKITEKT I KOSOVËS SË LIRË**



Halil RAMA -Mjeshtëri i Madh

FAQE 8

## PERSONAZH

**SKËNDER KAPO LENA, SIMBOL I MIRËSISË NJERËZORE**



Vlerësimet në librin e Pandeli Bardhit "Në rrjedhën e jetës - nga Kapo e Hançe te Skender Lena"...

FAQE 6

SHQIPTARËT NDEROJNË DËSHMORËT E KOMBIT TË TË GJITHA KOHËRAVE

# LAVDI PËRJETË

# DËSHMORËVE TË ATDHEUT!

## NDERIMI

**TATJANA PARLLAKU ÇARKAXHIU: MIRËNJOHJA E KRYESISË SË OBVLP PËR BESNIK KABËN**

FAQE 14

## NDERIMI

**"QYETAR NDERI I PUKËS", TITULLI MERITUAR PËR HUMANISTIN E FILANTROPIN E SHQUAR GJON BERISHA**

PROF. XHEMAL MEÇI  
STUDIUES, "MJESHTËRI I MADH"...

FAQE 16

## ESSE

**KOMISARI IM, BEGATOR KOZELI**

Vasil Premçi  
FAQE 15

## URIMI

**OVLP URON VETERANIN GENC BALLANCA NË 97-VJETORIN E DITËLINDJES**

FAQE 14



## PIONIERË DËSHMORË TË ATDHEUT


Nga Prof.asc.dr. Bernard ZOTAJ - Mjeshtëri i Madh

FAQE 3

FAQE 3

## 100 VJETORI I LINDJES

**EDIP OHRI, LEGJENDA E AVIACIONIT SHQIPTAR**



• OBVLP: MË 8 MAJ 2026, SESION JUBILAR PËRKUJTIMOR NË NDERIM TË JETËS DHE VEPRËS SË PERSONALITETIT TË SHQUAR TË LANÇ DHE AVIACIONIT LUFTARAK SHQIPTAR

FAQE 5

• Çdo 5 maj përulemi me respekt para dëshmorëve që ranë për pavarësinë e Shqipërisë. Para patriotëve që kanë dhënë jetën për mbrojtjen e integritetit territorial, trojeve, lirisë e pavarësisë së atdheut. Para 28 mijë dëshmorëve partizanë që dhanë jetën për çlirimin e Shqipërisë. Përulemi para kujtimit të luftëtarëve partizanë të huaj që ranë për çlirimin e Shqipërisë...

FAQE 3

FAQE 3

## 82-VJETORI

**BRIGADA E 12-të SULMUESE LA NË ALTARIN LIRISË 105 DËSHMORË**

FAQE 4

## REFLEKSIONE

**Tri fotografi që tregojnë turpin e atyre që mohojnë rezistencën e shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore**

Nga ROLAND QAFOKU  
FAQE 4

## PROFILI

**HYSEN SHEHU GJENERAL I SHQUAR DHE KLERIK I LARTË SHQIPTAR**

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI;  
Dr. në proces Robert SHEHU  
FAQE 10

## TAKIMI

**PSE E NDËRPREU BRESHËRINË AUTOMATIKU I SKËNDER-BEGASIT INDRIT CARA MBI PUSHTUESIT SËRBI...???**

Kolonel Trifon Llupo  
FAQE 13

## LIBRI

**INDRIT CARA-KAVAJA, DËSHMOR I KOMBIT BIE NË LUFTË PËR LIRI, NË DHEUN E DARDANISË. 31 MARS, 1999**

KADRI TARELLI  
FAQE 12

## HISTORIA

# KONGRESI HISTORIK I PËRMETIT NË KUJTIMET E GJENERAL RRAHMAN PARLLAKUT

- *Kongresi mori një sërë vendimesh, të cilat vazhdojnë të gjykojnë nga historia për pasojat e tyre. Vendimet e karakterit ushtarak, Parllaku i ka gjykuar gjithmonë të drejta dhe koha e ka vërtetuar drejtësinë e tyre. Ishte i drejtë vendimi për krijimin e strukturave ushtarake në shkallë taktiko-operative, si krijimi i divizioneve e korparmatave, të afta për të ndërmarrë luftime dhe operacione mësymëse e mbrojtëse të një lufte frontale...*

## NË PËRMET NË PRAG TË KONGRESIT

Në Përmet ishin mbledhur delegatë nga të gjitha repartet e Ushtrisë Nacionalçlirimtare në shkallë vendi. Dihet se nga krahinat e Shqipërisë së Mesme dhe sidomos ato të Veriut kishte më pak delegatë, pasi atyre u duhej të udhëtonin në zona të paçliruara, jashtë rrugëve kryesore të cilat ishin të kontrolluara nga armiku, kur udhëtimi bëhej vetëm në këmbë. Por, pavarësisht vështirësive e pengesave të shumta, delegatët pjesëmarrës ishin nga të gjitha qarqet e vendit.

Qyteti i Përmetit gumëzhinte nga gjallëria. Zëra të hareshëm dëgjoje ngado. Shikoje delegatët që shëtisnin grupe-grupe, takoheshin me njëri-tjetrin, shkëmbenin mendime, tregonin për betejat me armikun, për dëshmorët e rënë në luftë, për jetën në ilegalitet në ato qytete e krahina që mbaheshin ende nga okupatori, etj.

Në grupe shpaloseshin këngë e valle të krahinave të ndryshme, por sigurisht mbizotëronte pasuria folklorike e jugut të Shqipërisë, pasi andej vinte dhe pjesa më e madhe e delegatëve. Në ato momente të gjithë përjetonin një mrekulli gëzimi e hareje, që ua sillte fryma e lirisë që po afronte.

Nuk kish si ndodhte ndryshe. Ishin pothuajse të gjithë të moshës nga 16 deri 25 vjeç dhe optimizmin e kishin në gjak.

Në prag të Kongresit, Përmeti ishte gjithë gjallëri. Përmetarët si mikpritës të mirë e kishin pastruar qytetin e tyre nga mbeturinat e gërmadhave të djegura e të shkatërruara nga pushtuesi dhe jo vetëm në rrugët e sheshet kryesore, por edhe në rrugicat anësore. Kishin zbardhur me gëlqere muret e suvatë e shtëpive, duke bërë gati gjithçka për të prituri mysafi rë nga e gjithë Shqipëria. Mikpritja e veçantë e çdo familjeje të qytetit dëshmoi edhe një herë për fi snikërinë e popullit të Përmetit. Një moment të rëndësishëm shënoi mbërritja në Përmet e udhëheqësve kryesorë të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Të gjithë delegatët e Kongresit dhe populli i Përmetit, me pankarta e parrulla, i pritën ata në hyrje të urës mbi lumin Vjosë. Entuziazmi ishte i madh. Ndalea e tyre u bë në të vetmen kafene që i kishte shpëtuar djegies së qytetit.

## "KRAJLI", HALLVAXHIU NGA LUMA

Pas një pushimi të shkurtër filluan takimet e Enver Hoxhës dhe të udhëheqësve të tjerë me delegatët e Konferencës. I pari u prit grupi i Qarkut të Gjirokastrës dhe pas tyre u prit grupi i Vlorës.

Kur po takoheshin, Rrahmani u ndalua nga Liri Gega e Hysni Kapo, të cilët e prezantuan te Enveri:

"Ky është "Krajli", hallvaxhiu nga Luma".

Enveri u përgjigj: "E kam lexuar karakteristikën e tij dhe gëzohem që po takohemi".

"Krajli" mbeti i suprizuar nga kjo ngjarje e veçantë.

Pasditë, Parllaku u ftua në takim nga Nako Spiru, të cilin e takonte për herë të parë, por e njihnin njëri-tjetrin



nëpërmjet Ramize Gjebresë, të fejuarës së tij, e cila drejtonte rininë e Qarkut të Vlorës dhe ishte anëtare e Komitetit Qarkor të Rinisë Komuniste.

"Të bisedojë me Ramizenë ishte kënaqësi, - tregon Parllaku.

- Jo vetëm mësoja nga mençuria e saj, por edhe informohesha për të rejtat që më sillte nga Tirana, pasi dihej roli i Nakos në luftë, se de facto luftën e udhëhiqte ai.

Nakoja më tha: "Mirë more Rrahman, ta zëmë se Ramizeja u dashurua me Zahon, duke qenë e fejuar me mua, po pse duhej vrasje. Këto janë ekstremizma, që jo vetëm vrasin njerëz me vlera, por edhe na dëmtojnë luftën".

Mua më kishte ardhur shumë keq për Ramizenë dhe nuk isha dakord me vrasjen e saj, por të them të drejtën, nën ndikimin krahinor, nuk e di në do të kisha mbajtur qëndrim kulturor të Nakos, po të kisha qenë në vend të tij", pohon Rrahmani.

## NË KONGRESIN E PËRMETIT

Kongresi u hap në mënyrë solemne. Fjalën e hapjes e mbajti Dr. Omer Nishani, kurse fjalën për arritjet në Luftën Nacionalçlirimtare dhe për fitoret e ushtrisë partizane në këtë luftë e referoi Enver Hoxha, Komisar i Shtabit të Përgjithshëm. Më pas, fjalën e morën disa nga udhëheqësit e luftës si: Koçi Xoxe, Nako Spiru, Ymer Dishnica, Sejfulla Malëshova e të tjerë. Pas tyre filluan diskutimet e delegatëve. Delegatët ushtarakë u përqëndruan kryesisht te fitoret e arritura me shumë sakrificë ca dhe në kushte tepër të vështira lufte, por duke demonstruar krenarinë për fitoret, duke prurë përvojën e tyre dhe duke shkëmbyer mendime për të ardhmen.

Delegatët që vinin nga terreni folën për luftën në kushte e rrethana tejet të vështira të ilegalitetit, sidomos në qytete, për raprezaljet e terrorin që kishte ushtruar okupatori me burgime, vrasje e internime. Ata folën për punën e madhe që bënin organizatat



e frontit në krahinat e okupuara, për rritjen e rezistencës dhe nxjerjen e vullnetarëve drejt repartëve partizane, kurse për punën në zonat e çliruara, atyre iu diltë si detyrë të organizonin në ndihmë të ushtrisë vullnetarë të rinj, që do të siguronin armatime dhe do të bënin furnizimin me ushqime e me veshmbathje. Gjithashtu, do të merreshin masa për forcimin e pushtetit të zonave të çliruara drejt një qeverisjeje sa më të mirë. Diskutimet dhe analizat ishin tepër optimiste, të mbështetura në fitoret e arritura dhe mbi këtë bazë parashikoheshin fitoret e reja drejt çlirimit të shpejtë të vendit.

Diskutimet entuziaste të delegatëve, të cilët ishin pothuajse të gjithë të rinj, kishin bazë të fortë në realitetet e kaluara dhe në ato që po jetonin ato ditë. Të gjithë ishin ndeshur e po ndesheshin me armiq shumë herë në raporte më superiore si në njerëz, armatime e në teknikë luftarake, me ushtri të organizuar, të përgatitur mjaft mirë e të drejtuar nga ofi cerë akademistë.

U bë bilanci i luftimeve të zhvilluara para Kongresit të Përmetit, për operacionin e egër të ushtrisë naziste, që përfshiu të gjithë vendin tonë, nga Tropoja deri në Konispol, në mes të një dimri të acartë, me qëllim asgjësimin e Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe shuarjen e lëvizjes antifashiste në Shqipëri, por kishte ndodhur mrekullia.

Partizanët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, edhe pse me mungesa të mëdha në ushqime e veshmbathje, me armatim trofe rrëmbyer ushtrive armike, duke ndenjur ditë pa ngrënë, vetëm me çka u jepte populli, të cilëve iu ishin djegur shtëpitë e iu ishte shkatërruar ekonomia, duke ecur zbathur në borë e akull me këmbët e mbledhura me lecka, që u kullonin gjak, por me kuadro komanduese që u rritën në luftë, e përballuan me guxim Operacionin e Dimrit dhe dolën fitimtarë. Njëri prej tyre ishte edhe "Krajli". Ushtria Nacionalçlirimtare dhe Lëvizja Antifashiste jo vetëm nuk u asgjësua



an, por përkundrazi u zmadhuan e u forcuan. Në kulmin e operacionit e në vijimësi u krijuan Brigada e VI, e VII, e VIII, e XII, etj. Lëvizja Antifashiste Nacionalçlirimtare u zgjerua në të gjithë vendin, duke çliruar krahina e qarqe të tëra. Këtë e dëshmonte edhe qyteti i çliruar i Përmetit, ku po zhvillohej Kongresi.

Në shkallë vendi, ushtria naziste gjermane ishte mbyllur brenda qyteteve të paçliruara dhe ishte vënë në mbrojtje të disa rrugëve për të siguruar lëvizjen dhe manovrimin e trupave të saj. Kishte ardhur momenti që Ushtria Nacionalçlirimtare të kalonte në mësymje të përgjithshme për çlirimin e të gjithë vendit. Dhe për këtë vendosi Kongresi.

## VENDIMET USHTARAKE TË KONGRESIT TË PËRMETIT SIPAS OPTIKËS SË PARLLAKUT

Kongresi mori një sërë vendimesh, të cilat vazhdojnë të gjykojnë nga historia për pasojat e tyre. Vendimet e karakterit ushtarak, Parllaku i ka gjykuar gjithmonë të drejta dhe koha e ka vërtetuar drejtësinë e tyre. Ishte i drejtë vendimi për krijimin e strukturave ushtarake në shkallë taktiko-operative, si krijimi i divizioneve e korparmatave, të afta për të ndërmarrë luftime dhe operacione mësymëse e mbrojtëse të një lufte frontale.

Gjithashtu ishte i drejtë vendimi për dhënien e gradave dhe vendosjen e hierarkisë ushtarake në ushtrinë partizane, etj.

Këto masa çuan në thyerjen me forca të përqëndruara të operacionit të madh dhe të fundit të ushtrisë naziste në Shqipërinë e Jugut, si edhe në ofensivën e përgjithshme për çlirimin e të gjithë vendit, që u arrit pa ndërhyrjen direkte të forcave aleate, siç kishte ndodhur në shumë vende të Europës.

(MARRË NGA LIBRI "RRAHMAN PARLLAKU - NJË LEGJENDË NË KUFIRIN E DY KOHËVE", të bashkëautorëve Halil Rama dhe Sakip Cami, fq. 55-59)

## NDERIMI

## SHQIPTARËT NDEROJNË DËSHMORËT E KOMBIT TË TË GJITHA KOHËRAVE

## Lavdi përjetë dëshmorëve të atdheut!

- Çdo 5 maj përulemi me respekt para dëshmorëve që ranë për pavarësinë e Shqipërisë. Para patriotëve që kanë dhënë jetën për mbrojtjen e integritetit territorial, trojeve, lirisë e pavarësisë së atdheut. Para 28 mijë dëshmorëve partizanë që dhanë jetën për çlirimin e Shqipërisë. Përulem para kujtimit të luftëtarëve partizanë të huaj që ranë për çlirimin e Shqipërisë...

Çdo 5 maj, Shqipëria, si të gjithë kombet e qytetëruar nderon dëshmorët e saj. 5 Maji është një ditë kujtese dhe nderimi për Qemal Stafën dhe mijëra të rinj e të reja që dhanë jetën për kauzën e Lirisë. Vrasja në 5 Maj 1942 e Qemal Stafës, ish sekretari politik i të rinjve komunistë, në nderim të veprës së tij, është caktuar të jetë Dita e Dëshmorëve. Respekti dhe nderimi për dëshmorët është shenjë e pjekurisë dhe fuqisë së një kombi. Respekti për të kaluarën është një investim për të ardhmen.

Çdo 5 maj përulemi me respekt para dëshmorëve që ranë për pavarësinë e Shqipërisë. Para patriotëve që kanë dhënë jetën për mbrojtjen e integritetit territorial, trojeve, lirisë e pavarësisë së atdheut. Para 28 mijë dëshmorëve partizanë që dhanë jetën për çlirimin e Shqipërisë. Përulem para kujtimit të luftëtarëve partizanë të huaj që ranë për çlirimin e Shqipërisë.

Çdo 5 maj përulemi para dëshmorëve të Shqipërisë që dhanë jetën duke luftuar për çlirimin dhe pavarësinë e Kosovës. Para oç cerëve e policëve dëshmorë të rënë në krye të detyrës, të cilët i kujtojmë e nderojmë bashkë me fëmijët dhe familjet e tyre. Para vajzave e djemve të Shqipërisë që kanë dhënë jetën gjatë misionëve paqeruajtës të NATO-s, në mbrojtje

të lirisë së popujve të tjerë dhe të mbrojtjes së paqes e sigurisë nga terroristët. Para dëshmorëve të kohës sonë që kanë rënë në krye të detyrës për mbrojtjen e jetës së qytetarëve nga krimi dhe mbrojtjen e pronës publike nga fatkeqësitë natyrore.

Çdo kohë ka dëshmorët e saj dhe ne i nderojmë ata duke punuar çdo ditë për idealet e tyre, për Shqipërinë. Dëshmorët nuk janë më P zikisht. Por me ne janë idealet dhe vepra e tyre. Nuk janë më nënat e dëshmorëve të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare, por janë mbesat, nipat e stërnipat e tyre. Janë fëmijët e oç cerëve dhe policëve të rënë në krye të detyrës. Janë fëmijët, nënat, motrat e vëllezërit e vajzave e djemve të rënë për lirinë e kombeve të tjera, të rënë në luftën kundër terrorizmit e krimit, në luftën për mbrojtjen e qytetarëve dhe pronës publike.

Në 5 maj i gjithë Atdheu mban frymën në respekt të pafund për të rënë për atdheun, martirët e kombit që sakriç kuan jetën e tyre e në emër të Shqipërisë. Lufta për çlirimin e atdheut gjaku i derdhur, jetët e s ijuara dhe sakriç cat sublime për lirinë e tij, janë gdhendur si dëshmia monumentale e një populli që ka luftuar në mënyrë të paepur me pushtuesit gjatë gjithë historisë së tij. Nderimi ndaj dëshmorëve, është nderim për historinë e pop-



ullit, por është edhe një referencë krenarie, që na frymëzon për ta mbajtur të shenjtë amanetin e tyre, Shqipërinë e lirë, shtëpinë tonë të përbashkët!

**Lavdi përjetë dëshmorëve të atdheut!**

## PIONIERË DËSHMORË TË ATDHEUT



**Nga Prof.asc.dr. Bernard ZOTAJ**  
**Mjeshtër i Madh**

**LEJLA MALO (1929-1944)**

Lejla Ali Malo lindi në dhjetor të vitit 1929 në qytetin e Delvinës. Mbaron shkollën fillore në vitin 1941. Me fillimin e vitit 1942, u aktivizua me lëvizjen, lexonte dhe shpërndante komunikatat dhe traktet në bazat e caktuara. Doli partizane dhe u inkuadrua në bat. Thoma Lula. Në luftën e Delvinës me skuadrën e saj luftonte në kalanë e qytetit, të rrethuar nga të gjitha anët. Armiqtë e kapën të gjallë. Ishte plagosur rëndë në këmbë dhe nuk ia arriti të tërhiqej. Ballistët e masakruan barbarisht partizanen 15 vjeçare. Populli i Delvinës në korrik 1944 pa një skenë të llahtarshme, ku ballistët e tërhoqën zvarrë në rrugët e qytetit duke rënë dëshmore për lirinë e Atdheut. Varri i saj gjendet në Varrezat e Dëshmorëve të Kombit në Tiranë. Në qytetin e Delvinës është një Lagje me emrin Lejla Malo.

**ALEKO QIRICI (1928-1943)**

Lindi në Delvinë në vitin 1928. Shtegëtoi në Tiranë dhe bënte punën e hamallit. Varfëria e shtyu

## PIONIERË DËSHMORË TË ATDHEUT

në rrugën e luftës antifashiste. Në vitin 1942 u aktivizua me Debatikun, duke shpërndarë trakte të Partisë për luftën. Një ditë në shtator 1943 duke ngjitur trakte ku sot është Teatri Kombëtar, e pa një gjerman dhe e ndoqte pas. Coli e kuptoi dhe vrapon ti shpëtojë, kalon me vështirësi telat e një oborri aty pranë, por nazisti e vrau. U përjetësua në filmin Debatik në personazhin Coli.

**ALI SPAHIU (1930-1944)**

Ali Spahiu lindi në Tiranë në mars 1930. Bir i një familjeje të varfër punëtori. E rritën prinderit me mundime. Ishte korriku i vitit 1944. Së bashku me tetë shokë iu ngjiten malit të Dajtit. Në luftë u pranua në radhët e organizatës së Rinisë Komuniste. Mori pjesë aktive në aksione e luftime që zhvilloi kompania e katërt e bat. 4 të Br. I S. Tregoi guxim e pjekuri në çdo luftim. Më 4 nëntor 1944 luftohej me vetëmohim për çlirimin e Tiranës, ku ra në betejë partizani i vogël Ali Spahiu.

**REXHEP ZEBI (1929-1944)**

Lindi në vitin 1929 në UshelENZA të Dibrës. U rrit me ndjenjën e punës dhe punonte në bujqësi. Ishte i interesuar të dëgjonte tregime antifashiste partizane. U nis dhe shkoi në Br. IV S. Mori pjesë në luftime si në Shengjergj, në Qafë Kërrabë, në Arbanë, në çlirimin e Elbasanit. Brigada iu afrua Tiranës me luftë. Rexhepi ishte në pozicion duke hapur zjarr. Para tij ra një shok. Rexhepi shkon dhe merr trupin e tij për të mos rënë në duar të armikut, plumbat e të cilit dëndësohen dhe Rexhepi plagoset rëndë, u vra trimërisht duke luftuar. Ishte nëntor 1944.

**JORGO VOGLI (1929-1944)**

Lindi në vitin 1929 në Qeparo të Himarës. U sistemua me punë në Tiranë për bukën e gojës. U aktivizua me veprimtarin e organizatës së pion-

ierit. U rreshtua partizhan në Br. III S që luftonte jashtë kufijve të atdheut. Ra dëshmor më 5 dhjetor 1944.

**QAZIM ALIMEMETI (1929-1944)**

Lindi në Tiranë në vitin 1929. Parnohet në organizatën e Debatikut që me krijimin e saj 10 shkurt 1942. Kreu disa aksione dhe armiqte po e gjurmonin. E plagosën dy herë. Herën e dytë derdhi gjak ditën që pranohej në Rininë Komuniste. Në janar 1943 doli partizan në zonën e Prezës hyri në radhët e Br. XXII S. Luftoi në Kukës, Shkodër e në Tuz-Deçiç. Iku nga spitali ku ishte shtruar dhe shkoi te shokët të vazhdonte luftën. Ra në fushën e nderit në Deçiç më 12 dhjetor 1944.

**RUSTEM SHEHU (1928-1944)**

Lindi në Shtigjen të Kukësit. Nga nxënës doli partizan dhe në Bicaj u formua Br. XXIV S duke u bërë efektiv i saj. Pushkën e zotëronte mirë. U përlesh në betejë në kodrat e Kamzës për çlirimin e Tiranës. Brigada luftoi në Urën e Zezë, afër Krujës, në Milot, në Lezhë e në Bërdicë, kundër nazistëve në tërheqje. Në luftime që u zhvilluan në Bajzë, u plagos rëndë, u çuan në spitalin e Shkodrës. Në dhjetor 1944 me gjithë mjekimet e shërbimin, pushoi zemra e djaloshi trim.

**ARISTIDH PANO (1929-1945)**

Lindi në Tiranë më 1929. Kreu gjinazin e shtetit deri në vitin 1944. Përkrahu Lëvizjen dhe shtëpia u bë bazë për Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare. Motra Urani Pano (dëshmore) ishte komuniste. U katvizua me organizatën e Debatikut. Në fillim të vitit 1944 rreshtohet në çetën e Pezës dhe partizan në Br. III S, duke luftuar edhe jashtë kufijve të Atdheut. U sëmur rëndë nga tifua e morrit dhe më 5 janar 1945 vdes në spitalin e Novipazarit të Jugosllavisë.

82-VJETORI

# Brigada e 12-të Sulmuese la në altarin lirisë 105 dëshmorë

**B**rigada e 12 Sulmuese u krijua në zjarrin e Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare. Ishte maj i vitit 1944, kur partizanët shqiptarë po vulosnim me betejat dhe gjakun e tyre fitoren e kësaj lufte çlirimtare, antifashiste, patriotike dhe emancipuese për Shqipërinë dhe kombet e qytetëruara.

Ishte 20 maji 1944, kur 600 partizanë e partizane të ardhur nga Zona e Parë Operative Vlorë-Gjirokastrë, në Sukë krijuan Brigadën e 12, nën drejtimin e Komandantit Refat Bajrami dhe Komisarit Qemal Klosi, dy personalitete të shquar të Luftës Antifashiste Nacional-Çlirimtare. Brigada e 12 ka shumë merita lufte, trimërie dhe heroizmi.

Por kjo Brigadë ka edhe një meritë të veçantë, që e dallon nga formacionet e tjera të Ush trisë partizane: numrin shumë të madh të vajzave luftëtare. Rreth 200 vajza ose 30 përqind e luftëtarëve të Brigadës ishin vajza.

Kjo rrethanë zbulon një tipar tjetër të vlerave antifashiste: lidhjen e tyre me vlerat shoqërore dhe kulturore

emancipuese. Antifashizmi nuk ishte vetëm çlirimi prej pushtuesve nazistë e fashistë, por hapi rrugën për progres të gjithanshëm politik, shoqëror e kulturor në gjithë botën e qytetëruar. Prej këtij progresi nuk përfituan vetëm kombet fituese, por të gjitha kombet, të gjithë vendet dhe të gjithë popujt. Brigada e 12 ka një bilanc të pasur betejash e fitoresh.

Pas përfundimit të Kongresit të Përmetit, luftëtarët e saj shkruan faqe heroizmi e lavdie në luftimet e Qafës së Këçikut, në Tepelenë, Kurvelesh, Vlorë, Llogara, Himarë, Thërpel, Vokopolë, Rehove etj. Njësisë të saj u takon merita e çlirimit të Sarandës, Vlorës, Sazanit, Peqinit, Rrogozhinës, Kavajes, Durrësit e Shijakut.

Brigada e 12-të Sulmuese la në altarin lirisë 105 dëshmorë, të cilët i kujtojmë sot me respekt e nderim të thellë.

Trimëria legjendare e djemve dhe vajzave të Brigadës së 12 nuk përfundoi më 29 nëntor 1944.

Ju, veteranët e saj, pasardhësit tuaj dhe familjet e dëshmorëve të lirisë



kini mbajtur e mbani gjallë frymën antifashiste, patriotike, progresiste dhe europiane të luftëtarëve të saj.

Dekoratat që ndrisin në gjokset tuaja janë mirënjohje dhe dëshmi e një epopeje nga më të lavdishmet në historinë tonë kombëtare, të devocionit e sakrificave sublime në shërbim të At-

deut, lirisë dhe progresit. Shkëlqimin e tyre nuk ka argument apo pseudo-historian që ta mohojë. Antifashizmi, atdhetarizmi, përkushtimi e sakrificat për liri e progres nuk vjetrohen kurrë.

Këto vlera qëndrojnë në themel të Europës dhe qytetërimit të sotëm perëndimor.

## Tri fotografi që tregojnë turpin e atyre që mohojnë rezistencën e shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore

**Nga ROLAND QAFOKU**

**J**anë tri fotografi që tregojnë shumë për atë që ndodhi më 7 prill 1939 në Shqipëri. Fotoja e parë është cover-i i tabloidit londinez "Daily Express", i datës 8 prill 1939. E gjithë faqja e parë është kushtuar këtij pushtimi duke theksuar se Evropa ishte ndryshe pas kësaj ngjarje. Titulli i madh është: "Duçe pushton Shqipërinë". Më poshtë vijon me rigonen "Mbreti Zog drejton ushtrinë e tij të vogël kundër 50 mijë ushtarëve italianë". Kuptohet që për kohën e kufizuar që gazetarët kishin në dispozicion, kanë menduar se atë rezistencë që kanë bërë shqiptarët në brigjet e Durrësit, Shëngjinit, Vlorës dhe Sarandës, e drejtonte vetë Zogu, por në fakt ajo ishte krejt spontane dhe në numrat në vijim "Daily Express" e ka sqaruar me të dhëna tejet të sakta.

Fotografia e dytë është e gazetës së Tiranës me emrin "Shtypi", një botim special i pasdites së datës 8 prill. Titulli i saj është: "Trupat mike fashiste hynë sot triumfalisht në Tiranë...". Turpin e madh që i mbetet në jetë të jetëve, kryeredaktori i kësaj gazete është kujdesur ta fshehtë duke mos vendosur në këtë shkrim as emrin e vetë e as emrin e ndonjë gazetari. Megjithatë, ky titull dhe e gjithë faqja e parë është njolla më e zezë në historinë e medias shqiptare. Ai nuk ka asnjë justifikim dhe tregon jo vetëm tradhëtinë kombëtare, por se si një gazetar shet edhe gjënë më të shtrenjtë në jetë vendin e vetë kundrejt interesit. Prandaj, sot, nuk duhet të habitemi kur

rezulton se disa kolegë shiten dhe blihen për interesa të huaja, ose edhe vendase të lidhur me krimin. Kjo faqe e parë e 8 prillit 1939 është prova që tregon ky është sport i vjetër në këtë lëmin tonë.

Fotoja e tretë është e një ushtari italian i plagosur rëndë në Portin e Durrësit më 7 prill dhe sipas të dhënave më vonë ka ndërruar jetë. Është nga ata ushtarë italianë që u vranë gjatë rezistencës së shqiptarëve në qytetin bregdetar nën drejtimin e Abas Kupit dhe heroit legjendar Mujo Ulqinaku.

Të tri fotot sëbashku tregojnë se as ngjarja e pushtimit italian nuk ishte bardh e zi. Pati shqiptarë që e lanë me gjak atë pushtim duke mbrojtur tokën e vet pa asnjë ndihmë nga shteti që atë ditë u shkërmoq si një parg rëre. Pa asnjë drejtim dhe organizim, por në emër të idealit, Mujo Ulqinaku me të rinj të tjerë u bënë heronj të heronjve të atyre ditëve, të cilët nuk luftuan për ndonjë parti, por për Shqipërinë.

Mbi të gjitha këto tri foto tregojnë se ai që mohon sot rezistencën e shqiptarëve gjatë Luftës së Dytë Botërore përbën një akt antikombëtar edhe më të rëndë se sa ata që e tradhëtuan realisht Shqipërinë e asaj periudhe. A pati në vijim kjo rezistencë problemet e veta? Sigurisht që partitë e krijuara patën vlerën e tyre në këtë rezistencë, siç patën edhe defektet, për të mos thënë edhe kryerjen e krimeve në disa përplasje civile me njëra tjetrën. Unë kam bindjen se shumica e atyre shqiptarëve që rrokën një armë dhe e përdorën

kundër italianëve dhe gjermanëve nuk e bënë as si komunistë, e as si ballistë. E bënë thjesht si shqiptarë. Mjafton një fakt tejet domethënës. Janë me qindra, në mos mijëra, djem dhe vajza studentë jashtë Shqipërisë, kryesisht në Itali, që lanë studimet dhe erdhën në Shqipëri për të luftuar fashizmin. Mos vallë ata erdhën për të mbështetur komunistët dhe ballistët? Kjo konfirmohet edhe nga thënia lapidare e një lideri komunist të asaj kohe që në një moment sinqeriteti tha: U gjithëm në mal si patriotë dhe zbritëm si komunistë. Pas kësaj historia u shkrua ndryshe.

Prandaj, të mohosh sot rezistencën e

shqiptarëve që nga 7 prilli 1939 deri në fund të nëntorit 1944 dhe ta quash madje edhe luftë civile, thjesht përdor një teori që kanë dashur dhe duan të gjithë armiqtë e shqiptarëve. Të rënë për atdheun jetojnë në memorien e të gjithë brezave pasardhës.



## 100 VJETORI I LINDJES

# EDIP OHRI, LEGJENDA E AVIACIONIT SHQIPTAR

• **OBVLP: MË 8 MAJ 2026, SESION JUBILAR PËRKUJTIMOR NË NDERIM TË JETËS DHE VEPRËS SË PERSONALITETIT TË SHQUAR TË LANÇ DHE AVIACIONIT LUFTARAK SHQIPTAR**

Këtë 8 Maj mbuhen 100 vjet nga lindja e legjendës së aviacionit luftarak shqiptar, ish-luftëtarit të paeprur të luftës Luftën e Dytë Botërore deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë nga okupatori nazifashist, Edip Ohri.

Ndonëse ndonjë kalemxhi i paguar s'ngurron të përbaltë personalitetin e ish-ushtarakut me kontribut të çmuar gjatë LANÇ dhe në krijimin e modernizimit e Ushtrisë Shqiptare, duke sajuar "urdhra" të tij për të sulmuar Jugun e Shqipërisë në vitin e mbrapshtë '97, ndërkohë që ishte në vitet e pensionit të pleqërisë, Edip Ohri njihet si figura më e shquar e Aviacionit Luftarak shqiptar, por edhe si një nga ushtarakët më në zë të Ushtrisë.

Përgjigjia më e saktë për këta shpifarakë është monografia "Edip Ohri, legjenda e aviacionit", e autorit të mirënjohur Agustin Z. Gjinaj.

Nuk mund të mohohet fakti që koloneli në pension e përjetoi me dhimbje revolucionin bolshevik të '97-tës, por pas kalvarit në burgjet e diktaturës ai i që përkushtuar totalisht familjes dhe Organizatës së Bashkuar të Veteranëve të LANÇ (OBVL), si Sekretar i Përgjithshëm i saj për afro dy dekada, derisa ndërroi jetë para nëntë vitesh (më 21 shkurt 2017) në moshën 92-vjeçare. Siç shkruan autori Gjinaj: "Ai ishte një pilot i madh që fluturoi me të gjithë tipat e avionëve, ndërkohë që mbi 20 vite ka qenë komandant i armës. Në kulmin e karrierës, u dënua si pjesë e grupit të "puçistëve" të Ushtrisë që do të përmbysnin pushtetin popullor. Ndërkaq, prej vitit 1974 – Edip Ohri ishte zgjedhur edhe deputet i Kuvendit Popullor të Shqipërisë, ndërsa në moshën 49-vjeçare, në kulmin e sukseseve e të arritjeve në punë, u lirua nga detyra për t'u arrestuar vetëm pak kohë më vonë, në ditën e lindjes së Enver Hoxhës me akuzën se donte të rrëzonte pushtetin popullor me anën e terrorit. U arrestua më 16 tetor 1980 me akuzën absurde për përgatitjen e një grushti shteti ushtarak dhe dhe propagandë antishtetërore. Pas disa muaj hetimi, Edip Ohri, së bashku me gjashtë oficerë të tjerë del në gjyq. Në janar të vitit 1981, dënohet me 14 vjet burg, dënim i kryer fillimisht në Ballsh në Zëmjen. Në vitin 1985, dërgohet në burgun famëkeq të Burrelit ku qëndron deri sa lirohet si rezultat i amnistisë së 29 nëntorit 1989. Në Burgun e Burrelit, Edip Ohri ishte me kategorinë e "armiqve të partisë dhe të pushtetit": gjenerallejtënant, Heroi i Popullit, Rahman Parllaku; gjenerallejtënant dhe Heroi i Popullit, Muhamet Prodani; gjenerallejtënant dhe Heroi i Popullit, Sadik Bekteshi; gjenerallejtënant Arif Hasako; gjenerallejtënant Vaskë Gjino; gjeneralmajor Gjin Marku; gjeneralmajor Abaz Fejzo; gjeneralmajor Halim Ramohito; gjenerallejtënant Mihallq Zichishti, ministër i Tregtisë së Brendshme dhe të Jashtme, Kiço Ngjela; ministër i Bujqësisë Maqo Como ministër i Jashtëm Nesti Nase; Fadil Paçrami sekretar i Komitetit të Partisë për Tiranën; Todi Lubonja kryeredaktor i "Zërit të Popullit" dhe drejtor i Televizionit Shqiptar; Gjergj Titani, ish-shef i Shtabit të Korpusit; Spartak Ngjela e Fatos Lubonja; Lipe Nashi, drejtor i Përgjithshëm i Naftës; Xhavid Qesja, ish-komisar i Br XXII S; Bardhyl Belishova; Skënder dhe Bashkim Shehu; kolonel Elhami Hado, nënkolonel Shaban Reçi etj.

Gjatë kohës së vuajtjes së dënimit të padrejtë, në burgun e Burrelit është i njohur dhe për pathyeshmërinë e treguar. Ai kishte cilësi të larta njerëzore, ndershmëri, sinqeritet, mirënjohje ndaj të tjerëve, përkushtim të patundur ndaj Atdheut.

## EDIP OHRI, PINJOLL I FAMILJES SË ISMAIL QEMAL BEJ VLORËS

Ish-komandanti i Aviacionit të Shqipërisë, kolonel Edip Ohri, ka lindur në Strugë në dekadën e parë të muajit janar të vitit 1926, por që zyrtarisht si ditëlindje e tij njihet data 8 maj 1926, ndërsa gati tërë jetën deri në vdekje e kaloi në Tiranë.

Është pjesëtar-fëmijë i familjes fisnike strugane Emirzade – Ohri, e pastaj fëmijë i birësuar i Qazim bej Qemal Vlorës, djalit të Ismail Qemal bej Vlorës.

Ushtaraku i karrierës, Edip Ohri, shumë herët mbetet pa babanë, Inajet Murat Emirzade – që më pas do të ndryshojë mbiemrin në Ohri- bashkë me dy motrat e tij, Edibën dhe Hyrmeten dhe vëllain, Dashamirin, në vitet kur babai i tij, Inajet bej Ohri, ishte emëruar kryetar i komunës Shën Vlash të Durrësit. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, Edip Ohri pa hezitim iu bashkëngjiti formacioneve luftarake të LANÇ-së, duke dëshmuar shpirtin e tij lirisht dhe antiokupatorial ndaj tokave shqiptare. Këtë veti, këtë karakteristikë nuk e posedonte vetëm Edipi, por edhe fëmijët tjerë

të Inajet Ohrit, Edibeja, Hyrmetja dhe Dashamiri, që vërteton brumosjen e tyre për ta dashur atdheun dhe popullin e tyre të lirë.

Shkollimin fillor e ka filluar në Strugë, ndërsa më pastaj atë e ka vazhduar në Shqipëri, duke qenë edhe normalist i Normales së famshme të Elbasanit, për të vazhduar studimet në shumë Akademi ushtarake të aviacionit. Nga ajo që ishte fëmijë i familjes fisnike Emirzade – Ohri, e pastaj fëmijë i birësuar i Qazim bej Qemalit, djalit të Ismail Qemal bej Vlorës, nuk ka përfutur asgjë, posikur që nuk kanë përfutur as familjarët e tjerë të Ismail Qemal bej Vlorës. Shumëkush në Tiranë, as nga më të afërmit, nuk kanë ditur deri para sa kohe, se është fëmijë të birësuar i Qazim bej Qemal Vlorës mbase nga modestia. Mirëpo, rëndësi ka ajo që vetë Edipi vazhdimisht e ka thënë: se Qazim beu, i ka brumosur dhe i ka edukuar që ta duan popullin shqiptar dhe Shqipërinë. Këtë amanet Edip Ohri ia ka çuar në vend plotësisht. Vajzat e tij shembullore, Mirjana dhe Arjana, si dhe mbesa Kleida Hadëri ndjehen krenare për veprën e lavdishme të babait e gjysht të tyre.

## 92 VJET JETË, 92 VJET HISTORI PËR EDIP OHRIN

Nëntëdhjetë vjet jetë, 92 vjet histori për Edip Ohrin sepse nga Normalja e Elbasanit, ai është pjesëmarrës aktiv në Luftën Nacional Çlirimtare bashkë me të vëllain Dashamirin dhe motrat, Edibën dhe Hyrmeten. Pas luftës, pas çlirimit të Shqipërisë, Edip Ohri i kushtohet profesionit të ushtarakut, aviacionit, duke u bërë edhe komandant i Forcave Ajrore të Ushtrisë Shqiptare, për t'u shndërruar në "Legjendën e aviacionit shqiptar", kolos prej ushtaraku, intelektual, patrioti dhe figure madhore shqiptare. Pa dyshim se një nga kolosët që ka dhënë Struga, ose fushëgropa e Strugës e Ohrit, krahas emrave të shquar si Hamdi bej Ohri, Zyhdi Ohri, Dr. Myrteza Ali Struga, Dervish Hima, Mustafa Baroti, Nuri Sojliu, Dr. Ibrahim Temo, kësaj liste i duhet shtuar edhe emri i Edip Ohrit, për meritat e tij që ka për Shqipërinë, për shqiptarinë në përgjithësi e bashkë me këtë natyrisht edhe për Strugën.

Ai, me personalitetin e tij, me karakterin, punën, sjelljen, përkushtimin, qëndrimin, vlerësimin e drejtë, vuajtjet, përjetimet gjatë jetës dhe karrierës së tij, kurrë nuk ka bërë asnjë veprim që do ta relativizonte Shqipërinë, shqiptarinë dhe Strugën, por gjithmonë ka qenë ballëlartë dhe krenar për Strugën.

Edip Ohri, me jetën, punën, veprimtarinë, përkushtimin, profesionalizmin, patriotizmin, nacionalizmin, vuajtjet, përjetimet e shumëllojshme, nuk e nderoi vetëm emrin dhe veten e tij, por nderoi dhe madhërii e nderoi emrin e familjes Ohri, madhërii e nderoi emrin e familjes së Ismail Qemal bej Vlorës, madhërii e nderoi Strugën dhe popullin strugan, madhërii dhe nderoi Shqipërinë, madhërii dhe nderoi shqiptarinë.

Edip Ohri mbetet një ndër emrat e përveçëm të figurave madhore shqiptare, mbetet kolos në kujtesën e pashlyeshme të historisë së Shqipërisë dhe shqiptarëve. Kur është fjala për vendlindjen e tij, për Strugën, Edip Ohri, ky kolos, sa herë që ka folur për jetën, veprën, arritjet dhe natyrisht edhe për vuajtjet e tij vazhdimisht përsëriste se ndjehej krenar për Strugën dhe popullin e Strugës. Vazhdimisht ai shprehej se: "Kurrë gjatë jetës punës dhe karrierës sime e tonën, nuk kam bërë dhe nuk kemi bërë asnjë veprim që do ta relativizonte dhe do ta turpëronte Strugën, por gjithmonë kam qenë dhe kemi qenë ballëlartë dhe krenar për Strugën. Më kanë akuzuar pse kam lindur dhe pse kemi lindur në Strugë, por vazhdimisht kam qenë dhe kemi qenë krenar për Strugën. Jam dhe jemi të lindur në Strugë, dhe Struga është vendlindja jonë, me të cilën gjithmonë pra jemi krenuar. Gjithmonë e kemi nderuar e lartësuar Strugën. Kemi qenë dhe jemi krenar. Kurrë, as në momentet më të vështira kur më kanë akuzuar pse kam lindur në Strugë, nuk e kam turpëruar Strugën por e kam madhëruar e lartësuar".

## 4000 ORË FLUTURIME, PA E NDËRPRERË ASNJËHERË PUNËN DREJTUESE SI KOMANDANT

Edip Ohri ishte një pilot i madh. Nuk kishte mjet ajror në Shqipëri, me të cilin nuk kishte fluturuar; me avionët luftarakë me helikë të tipit JAK dhe PO, me avionin bombardues, me avionët gjuajtës me helikë, me avionët reaktivë MIG-15, MIG-17, me supersonikun MIG-19; me helikopterët MI-1 e MI-4, si dhe me avionët e transportit. Ai realizoi rreth 4000 orë fluturime, pa e ndërprerë asnjëherë punën drejtuese si



komandant.

Në vitet që ai drejtoi Aviacionin Luftarak Shqiptar datohen të gjithë rikonstruksionet dhe ndërtimet e mëdha të infrastrukturës së kësaj arme si, në Aerodromin e Kuçovës në Heliodromin e Farkës, në Aerodromin e Rinasit, në Fushën e Pishë-Poros, më Aerodromin e Gjadrit etj.

Në funksionin e komandantit, Edipi e ka përfaqësuar Aviacionin Luftarak Shqiptar si ekspert ushtarak në organizmat e Traktatit të Varshavës dhe më pas në Republikën Popullore të Kinës. Ai ka qenë pjesëtar i delegacioneve shtetërore e ushtarake që janë takuar me Hrushovin në ish-BS, me Komandantin e Traktatit të Varshavës, me Çu En Lain e Mao Ce Dunin në Kinë, etj.

Edip Ohri ishte dhe një prind shembullor. Gjatë gjithë jetës së tij, me gjithë kalvarin e vuajtjeve u dhuroi bashkëshortes e dy vajzave që ishin dhe janë krenaria e gëzimi i tij, duke dëshmuar kujdesin e dashurinë e babait të tyre, ndaj fëmijëve. Ai ishte prind, mësues dhe edukator, që i rriti dhe edukoi ato me ndershmërinë dhe besnikërinë e patundur ndaj popullit e Atdheut tonë të dashur. Ai u dha atyre forcë, pathyeshmëri e krenari.

## "DEKORATA E ARTË TË SHQIPONJËS" PËR EDIP OHRIN

Me meritat të veçanta drejtuese, profesionalizëm të lartë, vizion e perspektivë, Edip Ohri luajti rolin vendimtar si strateg i aviacionit në krijimin e zhvillimin e kësaj arme, që nga krijimi i Repartit të Parë të Aviacionit në Laprakë e më pas regjimentet luftarake të Rinasit, Kuçovës, Farkës, Shkollës së Aviacionit, Uzinës së Aviacionit e deri Regjimenti i Gjadrit, duke pajisur Shqipërinë me 200 aeroplan. Gjatë karrierës së tij ushtarake, si pilot i Aviacionit të Shqipërisë, ka fluturua me avionët e parë P-2, P-9, Jak-16, helikopterët Mi-1, Mi-4, Il-14, Il-28 në Mig-ët 15,17,19,21. Aviacioni shqiptar, deri në vitet 1980 mund të konsiderohej i barabartë me fqinjët në teknike e eksploatim, sepse ai kishte një uzinë moderne, punonte me karburantin e prodhur në vend, kishte një shkollë aviacioni bashkëkohore, infrastrukturë e aerodrome të standardeve të larta, vendkomandë qendrore moderne e mbështetur me mjete navigimi e drejtimi modern, (deri radarë PLL-35 për drejtimin e Aviacionit Luftarak), helikopterë, aeroplanë të transportit AN-2, Il-14, si për fluturimet në kondita të thjeshta meteorologjike, të vështira, natën, por edhe të raketave moderne tokë-ajër SAM-2 dhe artilerisë së shumtë kundërajrore.

Gjeneral Rrahman Parllaku – "Hero i Popullit dhe Nderi i kombit", në vlerësim të figurës së Edip Ohrit është shprehur se: "Shteti shqiptar duhet t'i jetë mirënjohës pafundësisht Edip Ohrit për largpamësinë dhe organizimin që tregoi si Komandant i Aviacionit Luftarak, duke planifikuar, organizuar, realizuar dhe tërhequr në kohë ndihmat kineze për motorë e pjesë këmbimi për avionë, në atë masë, sa që ky aviacion nuk pati nevojë të harxhonte asnjë dollar, rubla apo valutë edhe për 30 vite të tjera, pas largimit të tij nga detyra. Si sekretar i përgjithshëm i OBVL-së, Edip Ohri, për 15 vite ka dhënë një kontribut të shquar për organizimin dhe konsolidimin e strukturave të kësaj organizate".

Pikërisht për këtë emër e kontribut të vyer, ish-Prezidenti i RSH, Bujar Nishani, i ka akorduar Edip Ohrit "Dekoratën e Artë të Shqiponjës".

## PROFILI

# SKËNDER KAPO LENA, SIMBOLI MIRËSISË NJERËZORE

- *Vlerësimet në librin e Pandeli Bardhit “Në rrjedhën e jetës – nga Kapo e Hançe te Skënder Lena”*



**Halil RAMA – Mjeshtër i Madh**

Një vizitë mbresëlënëse në qytetin turistik të Gramshit; një foto sa njëmijë fjalë tek memoriali kushtuar patriotit gramshiot Kapo Lena, ish - komandant i Batalionit Vërçë – Sulovë dhe veçanërisht vlerësimi i gjeneral Ismail Shulkut, ish zëvendës i Shefit të Shtabit të Përgjithshëm të FA dhe komandant i Frontit Verilindor, do më përforconte bindjen për personalitetin e Skënder Lenës si simbol i mirësisë njerëzore.

Para më shumë se një dekade për Skënderin, si mishërues dhe përçues i vlerave më të spikatura njerëzore, intelektuale dhe profesionale, më ka folur miku im i ngushtë, ish-mësuesi e drejtuesi shembullor i disa shkollave në Gramsh, Ismet Llapushi (me të cilin kishin lidhje të afërta gjaku). Ndërsa sot këtë vlerësim ma përforcon një tjetër personalitet i arsimit në rrethin e Gramshit, Abedin Bici, teksa më pohon se busti i patriotit Kapo Lena dhe ai i antifashistit Antonio Gramshi, të ideuara dhe ndërtuara me fondet e Skënder Lenës, janë përmendore të historisë së lavdishme të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare.

Ideimi dhe ndërtimi i tyre, si dhe i dhjetra veprave infrastrukturore, pallate, rrugë, lulishte (në Gramsh e Tiranë) kanë një emër të spikatur të këtij qyteti. Ai është Skënder Kapo Lena, “Qytetar Nderi” i Gramshit, “Ambasador i paqes” dhe anëtari themelues i Shoqatës Atdhetare Kulturore “Gramshi”.

Mesazhet që përcjellin shembullin e tij kanë emrin krenari. Krenaria ka nevojë për një truall, për një shtrat që rritet. E pikëtishtë në këtë shtrat ka ecur dhe ecën Ing. Skënder Lena, i përshtatur mirë me kohën, bujar, fisnik, humanist i pashoq, intelektual i mirëformuar dhe i zoti, që ka çarë në jetë me mençuri e sakrificë.

Si të tillë e gjejmë personalitetin e tij edhe në librin (monografi) të sapobotuar nga shkrimtari Pandeli Bardhi, me titullin sinjifikativ “Në rrjedhën e jetës – nga Kapo e Hançe te Skënder Lena”. Siç shkruhet në përcjelljen e këtij libri për lexuesin: “biznesmeni, patrioti dhe biri i denjë i Rashtës, Skënder Lena, me punën, mirësinë dhe përkushtimin qytetar u bë urë mes brezave, nga drita e etërve, te drita e njerëzve që e nderojnë sot emrin shqiptar”. Më tej, në parathënien e librit, redaktori i tij Ali Jaupi Normandi, i mrekulluar gjithmonë nga mënyra e të folurit të Skënderit me njerëzit, me shokët e vjetër, me bashkëmoshatarët, me ish-kuadro e punëtorë të thjeshtë, ndër të tjera shkruan: “Ai (Skënder Lena) është nga ata njerëz që gjënë më të bukur e sheh te dhënia, te ndihma, te kujdesi për tjetrin. Në shumë raste ndihma e tij ka mbërritur pa bujë, ashtu si krojet që shuajnë etjet tona në heshtje. Kjo është bamirësia e vërtetë, ajo që lind prej dashurisë dhe mbillet me modesti”.



**GJENERAL ISMAIL SHULKU: “SKËNDER LENA ËSHTË NJË PATRIOT I MADH...”**

Skënder Lena u lind në fshatin Rashtan të Gramshit, në një familje atdhetare me kontribute të spikatura gjatë LANÇ. Pas mbarimit të shkollës teknike, Skënderi punoi si specialist dhe si drejtues në ndërmarrje e institucione të ndryshme në Gramsh.

Gjeneral Ismail Shulku, në miqësi të ngushtë me të e familjen e tij që prej 30 vitesh kur ishte komandant i Brigadës së XVI të Këmbësorisë, Gramsh, (për pesë vjet nga 1977 e deri në fundin e vitit 1981), për librin monografik “Në rrjedhën e jetës – nga Kapo e Hançe te Skënder Lena”, ndër të tjera shkruan: “Figura e Skënder Lenës është shumëdimensionale. Jo vetëm unë, por çdo njeri do ta kishte shumë të vështirë të përshkruante ashtu si duhet në mënyrë të plotë figurën, cilësitë dhe meritat, punët e mira e të shumta që ka bërë Skënderi në dobi të vendlindjes së tij Gramshit si dhe për të ndihmuar njerëzit në nevojë sa herë që i kanë kërkuar ndihmë” (fq.140). Më tej gjeneral Shulku vlerëson se “Skënder Lena është patriot i madh edhe pse është biri i Kapo Lenës. Gramshi, në dijeninë time ka shumë biznese, madje dhe shumë të fuqishme, por asnjëri prej tyre nuk ka shpenzuar dhe ndërtuar në Gramsh më shumë se sa Skënder Lena”.

Pas vitit 1992 krijoi një kompani ndërtimi dhe punoi në Gramsh e Tiranë. Skënderi është dalluar për shpirtin e tij human. Ai ka ndihmuar familje e individë në nevojë, ka dërguar kompjutera në dy shkolla etj. Dhe nuk mburret si djali i patriotit të madh Kapo Lena, por ecën vendosmërisht në gjurmët e tij.

## **KAPO LENA, KOMANDANTI LEGJENDAR I LANÇ NË ZONËN E GRAMSHIT**

Nga libri “Në rrjedhën e jetës – nga Kapo e Hançe te Skënder Lena” që sapo ka parë dritën e botimit, ndër të tjera mësojmë për jetën dhe veprimtarinë patriotike të ish - komandantit të Batalionit Vërçë – Sulovë, Kapo Lena. “Ai ka lindur në fshatin Rashtan të Gramshit në vitin 1893 në një familje patriotike atdhetare. Prindërit e tij kanë luftuar e ndihmuar për Pavarësinë e Shqipërisë. Pushtimin e Shqipërisë nga Italia Fashiste e priti me urrejtje, po kështu edhe regjimin antipopullor të Zogut. Ka qenë pjesëmarrës në Revolucionin Demokratiko-Borgjez të vitit 1924; ishte i lidhur me idetë e revolucionit të Fan Nolit, për një Shqipëri të lirë, të pavarur dhe demokratike.

Kapo Lena, e ndjente shpirtërisht se Atdheu i zaptuar nga Italia fashiste, duhej çliruar me luftë e armë në dorë, ndaj u lidh qysh në fillim me Lëvizjen Antifashiste

## PROFILI

# SKËNDER KAPO LENA, SIMBOLI I MIRËSISË NJERËZORE

• **Gjeneral ISMAIL SHULKU:** “Skënder Lena është patriot i madh edhe pse është biri i Kapo Lenës. Gramshi, në dijeninë time ka shumë biznese, madje dhe shumë të fuqishme, por asnjëri prej tyre nuk ka shpenzuar dhe ndërtuar në Gramsh më shumë se sa Skënder Lena”.

Vijon nga faqja 6



Nacionalçlirimtare. Mori armën në dorë bashkë me luftëtarët e tjerë të rrethit, në luftë kundër postës së Snosmit dhe ushtrisë italiane në shkurt të vitit 1943 në Kodovjat, e në shumë beteja me gjermanët. Më vonë Komandant i Vendit në komandën e Kukurit mbas Operacionit Armik të Dimrit 1943-1944 dhe me organizimin e Batalionit Verçë – Sulovë, në pranverë të vitit 1944, u emërua komandant i këtij batalioni, detyrë që e kreu me devotshmëri, deri në çlirimin e plotë të Shqipërisë.

Kapo Lena kishte virtute e zakone burrërore, ishte i dashur dhe i respektuar, me çdo moshë, i njëjlojtë për çdo besim, seks e ngjyrë. Ishte i dashur e i respektuar me kuadrin e batalionit partizan, i dashur me të gjithë partizanët, besnik i fjalës, trim në luftën kundër armiqve dhe bashkëpunëtorëve të tyre.

Kapo Lena nuk kishte mbaruar ndonjë shkollë ushtarake ose shkollë politike, por përvoja, burrat e mençur, prindërit e tij, tarafi i miqësisë, urrejtja kundër armikut dhe vendosmëria për të çliruar atdheun, e bënë atë një ushtarak të zotë e politikan të matur, të dashur me gjithë popullin e rrethit tonë...Kapo Lena (1893-1995) dhe familja e tij mbas çlirimit të vendit, kanë mbajtur një qëndrim shumë të mirë dhe kanë dhënë një kontribut të shquar për edukimin e të rinjve dhe të rejave shqiptare, por edhe për të gjitha moshat.... Ai, me gruan e tij të nderuar Hançen, lindën dhe rritën tetë fëmijë që sot, punojnë në punë të ndryshme shtetërore dhe private. Ata janë të nderuar, të respektuar nga i gjithë rrethi familjar dhe e gjithë shoqëria që i rrethon...”. (Fq.43 – Nga fjala në ceremoninë e varrimit, mbajtur nga miku, shoku e bashkëluftëtari, Haki Musai, ish-zëvendëskomandant i batalionit Verçë-Sulovë).

## SKËNDER LENA, MISHËRUES DHE PËRÇUES I VLERAVE MË TË MIRA NJERËZORE, INTELKTUALE DHE PROFESIONALE

Skënder Lena vlerësohet nga bashkëkohësit si mishëruesi dhe përçuesi i vlerave më të spikatura njerëzore, intelektuale dhe profesionale. Por gjithësesi në monografinë e shkruar me dashuri, pasion e talent nga Pandeli Bardhi, del më i plotë profili i tij si simbol i mirësisë njerëzore. Kjo, falë mjeshtërisë dhe talentit të autorit Bardhi, i cili e plotëson profilin e Skënder Lenës me vlerësimet e atyre që kanë punuar me të ose që e kanë njohur nga afër. Kështu Jean – Luc EMERY – Administrator i Fondacionit “Komiteti i Ndihmës Mjekësore” i cili ka ardhur në Shqipëri në vitin 1999, si humanitar nëpërmjet organizatës “Commite d’ Aide Medicale”, në fushën e ndërtimit dhe arkitekturës, veçmas e vlerëson Skënder Lenën si një nga bashkëpunëtorët më të mirë, me të cilin ka punuar prej rreth 25 vitesh dhe për të mbetet një mik i mirë. “Firma ‘LISECI’ që z. Skënder drejton, ashtu si mali nga ku ka marrë emrin, qëndron hijerëndë në trevat e Gramshit, për të dëshmuar lidhjen e ngushtë me vendlindjen, me nevojat e patriotëve gramshiotë dhe për t’u shërbyer



atyre me përlësi, sikurse vetëm z.Skënder Lena di”, shkruan Jean – Luc EMERY. (fq.143). Ndërsa ish - kryetari i Bashkisë Gramsh, Klodian Tace veçon si një nga veprat më të bukura që lidhet me emrin e Skënder Lenës, parkun e vogël me shatërvanë, i cili sot është kthyer në një oaz gëzimi për të rinjtë dhe të moshuarit. Kjo sipas tij se çdo pikë uji që buron prej atij shatërvani të kujton shpirtin bujar të Skënderit, që deshi t’i dhurojë Gramshit një hapësirë të thjeshtë, por me shumë domethënie, një vend ku njerëzit të pushojnë, të bisedojnë, të qeshin dhe të gjejnë pak freski në ditët e nxehta... “Skënder Lena, ose njeriu me dy zemra”, -kështu e personifikon gramshiotin emërndritur Kryetari i Federatës së Paqes Universale Shqipëri, Defrim Methasani, mjeshtër i moderimit të eventeve dhe i dokumentarit televiziv. “Njëra zemër i punon për familjen e tij dhe tjetra për miqtë e njerëzit në nevojë...Njerëz si Skënder Lena janë asete njerëzore për familjen dhe shoqërinë, por mbi të gjitha janë edhe vlerë për Shqipërinë”, shkruan ndër të tjera ikona e gazetarisë sportive Defrim Methasani.

Fjalë zemre, dashuri dhe respekt për Skënder Lenën shprehin në shkrimet e tyre, pjesë e kësaj monografie, edhe Drejtoresha e Spitalit të Përgjithshëm Gramsh, Greta Lena; Dr. Kastriot Hasa; Margarita Llapushi Zeneli; gazetari i mirënjohur Bashkim Koçi e dhjetra të tjerë.

Vetë Skënderi e ndjen veten të lumtur që mbi të gjitha ka një familje të mrekulueshme dhe çdo sukses në punë ia dedikon bashkëshortes shembullore, Lirisë, e cila për të dhe fëmijët ka kontribute të veçanta, që jo çdokush nënë dhe bashkëshorte i ka. Ai kujton veçanërisht periudhën mbi tri vjeçare, kur e gjithë barra e ekonomisë në familje dhe shtëpi i ra Lirisë, e cila me shumë mund e përballoi me sukses, duke rritur dhe dy fëmijët e tyre, djalin Orgesin dhe vajzën Odeta, si dhe përkujdesjen shembullore ndaj vjehrrit Kapo Lena deri në çastet e fundit të jetës në moshën 102 vjeçare. Sot Skënderin dhe Lirinë, me të drejtë i gëzojnë arritjet e djalit Orgesit që ka qenë dhe mbetet shumë i angazhuar, duke ndihmuar në firmën “Liseci”, ndërkohë që bashkëshortja e tij, Arjola ka një biznes parukerie që e menaxhon me shumë sukses. Po ashtu, Skënderi dhe Liria i gëzohen edhe arritjeve të vajzës, Odetës që e martuar me Landi Çamin kanë një harmoni të shkëlqyer me njëri-tjetrin. Ata kanë dy djem, Aleksandrin dhe Andrean.

Ndaj edhe bashkëshortët Liri e Skënder Lena vlerësojnë mbi të gjitha pasuritë, dashurinë dhe harmoninë mes tyre, djalit dhe vajzës..., por edhe me miqtë e shokët e shumtë në Gramsh, Tiranë e në gjithë Shqipërinë.



Foto familjare. Mishela, Drita, Gëzimi (dy prindërit e Armandos), Liria, Skënderi, Orgesi, Arjola dhe Armando (dhëndëri i Orgesit).

## PERSONALITETE

NË 110 VJETORIN E LINDJES DHE 25 VJETORIN E NDARJES NGA JETA

## Fadil Hoxha-arkitekt i Kosovës së lirë

Halil RAMA

Me një vështrim realist të kushteve dhe rrethanave historike nëpër të cilat kaloi Kosova, në vitet e thyerjeve të mëdha dhe krizës së pushtetit, janë të rrallë personalitete që u kundërqëndruan sfidave, provokimeve, përndjekjeve, hileve dhe dredhive politike të panumërta, në mënyrë aq stoike, si Fadil Hoxha. Ai pati vizionin e një politikani patriot e modern, i cili projektoi dhe sendërtoi të ardhmen e atdheut të tij.

Në dy libra të botuar në Prishtinë: “Fadil Hoxha siç e njoha unë” i akademik Ekrem Murtezai dhe “Fadil Hoxha në veten e parë”, me parathënie nga publicisti Veton Surroi, personaliteti më emblematic i Kosovës së periudhës së Luftës së Dytë Botërore dhe i pasluftës, kur Kosova qe e okupuar nën pushtetin serb, paraqitet si udhëheqës dhe pushtetar ithjeshtë, pa ekstravagancë apo kryelartësi.

Në këto botime, si dhe në film-in dokumentar televiziv “Fadil Hoxha-arkitekt i Kosovës së lirë” – prodhim i Radiotelevizionit Publik Shqiptar (ku jam bashkëskënarist me Dr.Hajri Mandrin), Fadil Hoxha evidentohet si misionari historik që vjen e na zgjon për motivime të mëdha kombëtare, si personaliteti që mbushi me frymë krijuese një shekull, për t’i dhënë Në çaste kritike, i urtë e racional, kolos i luftës, sa romantik në ëndërrime aq realist në veprime, e lindi vuajtja e popullit të tij për t’u ngritur mbi dallgët e shantazhet politike sifeniksi nga hiri.


Ai lindi në Gjakovë (15 Maj 1916), por njerëzit e mëdhenj nuk i nxënë qyteti, ai u bë bir i tërë Kosovës dhe Shqipërisë që e ëndërroi tërë jetën si komb të bashkuar. Fadili nuk krijoi pasuri por la veprën e Tij: Kosovën e lirë me vështrimin drejt demokracive të përparuara e të qytetëruara, ai sot është Kosova në ecje, jeta në prosperitet dhe liria e demokracia në hapësiratë reja! Fadil Hoxha bashkë me shokët e tij Xhavit Nimanin, Xhevdet Hamza, Veli Dema, Xhafer Vokshi etj. i qëndrojnë historisë Kosovës si kostelacion yjesh në qiellin e demokracisë.

Personalitete kosovare të botës akademike e të letrave e personifikojnë Fadil Hoxhën si intelektualin e udhëheqësin komunikues, të hapur, të çiltër dhe të ngrohtë me të gjithë, si burrështetasin që ngrihet në lartësitë morale të burrave të rrallë të kombit shqiptar që ende na fton e na thërret, për më shumë dashuri amtare për më shumë dinjitet!

Sipas Akademikut Ekrem Murtezai, Fadil Hoxha ka bërë për Kosovën optimumin e asaj që ka qenë e mundur në kushtet, rrethanat dhe në situatën e atëherëshme brendapërbrenda sistemit socialist e monist”.

Ekrem Murtezai që nga viti 1969 e deri në vitin 1973 ka qenë shef i Kabinetit dhe këshilltar i pavarur i

• *Gjeneral Rrahman Parllaku – Hero i Popullit dhe “Nderi i Kombit”, në librin e tij testament “Memoria historike e Kombit” shkruan se: “Për mua, Fadil Hoxha është më i madhi i të gjithë shqiptarëve, qofshin në Shqipëri apo në Kosovë. Më i madhi duhet të ishte Enveri, po të mos kishte pushkatuar të vetët Fadil Hoxha, si burrë shteti, me aftësi e dinjitet, me zgjuarsis e largpamësi të jashtëzakonshme, duke shfrytëzuar më së miri konjunkturën e brendshme politike në ish-Federatën Jugosllave, arriti ta bëjë Kosovën pjesëkushtetuese të Federatës”...*



Fadil Hoxhës, i cili në Kongresin e IX, u zgjodh anëtar i Byros Ekzekutive të Kryesisë së LKJ që ka qenë maja e piramidës në hijerharhinë partiake jugosllave.

Në librin e tij “Fadil Hoxha siç e njoha unë” Akademik Ekrem Murtezai veç tjerash shkruan: “Fadil Hoxha për shqiptarët ka bërë tërë atë që ka qenë e mundur në kushtet mjaft të pavolitshme ekonomike, politike, kulturore dhe ndërkombëtare, duke dhënë optimumin e mundshëm brendapërbrenda sistemit. Në bazë të angazhimit të tij si politikan numër një i Kosovës, si tribun, mund të them se Fadil Hoxha ka meritën më të madhe se kushdo tjetër nga drejtuesit e tjerë kosovarë jo vetëm për arritjet e shqiptarëve në federatën jugosllave, por, më tepër, edhe për atë që kemi sot – shtetin e ri të pavarur dhe sovran të Kosovës, sepse pa

Kushtetutën e vitit 1974, do të kishte shumë vështirësi juridike ndërkombëtare në përkrahjen e UÇK-së.

**REXHEP QOSJA: FADIL HOXHA MË MBRONTE MUA DHE KONCEPTIN E SHQIPËRISË ETNIKE**

Akademik Rexhep Qosja, për Fadil Hoxhën, në Klan Kosova në vitin 2015, thotë: “Unë e di një gjë, Fadil

Hoxha ka thënë të mbrojmë intelektualin, sepse e ka ditur se tehu i sulmeve të Serbisë ishte drejtuar kundër intelektualëve të Kosovës. Në takimet që kam pasur me Fadil Hoxhën, Mahmut Bakallin dhe Xhavit Nimanin, ata i kam perceptuar duke bërë sjellje në pjesën më të madhe të dinjitetshme.

Ata flijonin interesat e veta të ngushta dhe mendonin për interesat e Kosovës. Serbia ka bërë çmos që në vitin 1981 dhe 1982 të vëjë administratë ushtarake në Kosovë. Këtë tragjedi e ka parandaluar Fadil Hoxha”. Më tej akademiku i mirënjohur kosovar shprehet se: “Prej rreziqeve që më janë kanosur, jo vetëm për dënim politik, por edhe për pushim nga puna, edhe për burgosje, më ka shpëtuar një njeri që është figura më e shquar politike e Kosovës dhe quhet Fadil Hoxha. Ai në mënyrë të hapur u ka thënë zyrtarëve që vendosnin për fatin e intelektualëve, mbani duart larg prej Rexhep Qosjes.

Më kanë shkarkuar nga detyra e drejtorit, më kanë dënuar edhe partiakisht, por nuk më kanë burgosur. I kam një borxh moral e njerëzor Fadil Hoxhës dhe këtë e kam thënë hapur dhe shpjeguar në ditar. Të mos harrojmë se Fadil Hoxha ka qenë nxënësi i Normales së Elbasanit dhe sado që ka qenë zyrtar i lartë në Jugosllavi, që

zbatonte politikën e atij shteti, ishte atdhetar gjithëkombëtar. Kam pasur tri a katër biseda me të, në katër sy, dhe e kam ndjerë, e kam parë, dhe e kam përjetuar nostalgjinë që kishte Fadil Hoxha për Shqipërinë”.

Një tjetër personalitet i mirënjohur kosovar, Akademik Pajazit Nushi në një intervistë dhënë RTK-së në vitin 2015 shprehet se: Fadil Hoxha ka vdekur si thotë populli me “zhigun” e bashkimit të Kosovës me Shqipërinë. Kjo ka qenë vija konstante e politikës së tij. Jam i sigurt që ka shku me brengën që Kosova (ende) nuk është bashkuar me Shqipërinë. Për aq sa e kam njohur Fadil Hoxhën, për këtë jam i sigurt.

Po ashtu akademiku i shquar i Kosovës, Jusuf Bajraktari – ish Kryetar i Akademisë së Shkencave të Kosovës, vlerëson se: Fadil Hoxha është njeriu, luftëtari, komandanti, politikani dhe burrështetasi që me përkushtim, vuri emrin e Tij, në altarin e personaliteteve që personifikojnë historinë Kosovare si një nga figurat e mëdha shqiptare të shekullit që lamë pas. Intervista...

Prof. Dr. Hakif Bajrami, historian dhe publicist i njohur shqiptar shkruan se: Fadil Hoxha e përkushtoi jetën dhe veprimtarinë e tij në

Vijon në faqen 9

## ESSE

## NË 110 VJETORIN E LINDJES DHE 25 VJETORIN E NDARJES NGA JETA

## Fadil Hoxha-arkitekt i Kosovës së lirë

## Vijon nga faqja 8

shërbim të pandërprerë të atdheut, aktiviteti i tij shumëdimensional nga komandant i talentuar i shtabit të përgjithshëm të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, burrshteti dhe patriot i flaktë, u bë symbol përkushtimit atdhetar.

Idhulli ipartizanëve të Kosovës, Udhëheqësi i shquar i shtetndërtimit në gjysmëshekullin e pasluftës, kurrë nuk iu nda epiteti “separatist” nga Beogradi. Historia e luftës dhe pasluftës ka emrin mendjen dhe veprën e babait separatist, Fadil Hoxha. Nga llogoret e Luftës deri te piramida e pushtetit, nga akuzat dhe burgjet, deri te mirënjohja e heroit të Kosovës, me adhurimin më madhor publik, shtrihet jeta dhe vepra e këtij vigani liberator!

Prof. Dr. Masar Rizvanolli – Kryetar i Shoqatës së Intelektualëve “Jakova”, ndër të tjera vlerëson se “Fadil Hoxha ishte ndër themeluesit e parë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe aradhave partizane, në krye të së cilës ishte vetë ai... gati në të gjitha betejat ishte luftëtar me armë në dorë, duke u treguar strateg i niveleve të larta ushtarake.

Po ashtu gjeneral Rrahman Parlaku – Hero i Popullit dhe “Nderi i Kombit”, në librin e tij testament “Memoria historike e Kombit” shkruan se: “Për mua, Fadil Hoxha është më i madhi i të gjithë shqiptarëve, qofshin në Shqipëri apo në Kosovë. Më i madhi duhet të ishte Enveri, po të mos kishte pushkatuar të vetët Fadil Hoxha, si burrë shteti, me aftësi e dinjitet, me zgjuarsia e largpamësi të jashtëzakonshme, duke shfrytëzuar më së miri konjunkturën e brendshme politike në ish-Federatën Jugosllave, arriti ta bëjë Kosovën pjesëkushtetuese të Federatës”.

## PAK RADHË PËR FILMIN DOKUMENTAR KUSHTUAR FADIL HOXHËS

Filmi dokumentar “Fadil Hoxha-arkitekt i Kosovës së lirë” që u promovua më 15 shkurt 2022 në sallën e Akademisë së Shkencave në Tiranë, në praninë e më shumë se 100 personaliteteve akademike e publike nga Tirana e Prishtina, (ku unë jam bashkëskënarist me dr. Hajri Mandrin dhe me regjisor të mirënjohur Llesh Nikolla – “Mjeshtër i Madh”, e konsulent z. Bashkim Hisari), është një prodhim me metrazh të gjatë, 47 minuta, i cili i kushtohet veprimtarisë së Fadil Hoxhës, për periudhën 1932 deri 2001, si lideri kryesor në historinë e Kosovës.

Filmi jep një përmbledhje të zhvillimeve politike, historike dhe kulturore në Kosovë, duke u fokusuar te kontributi politik dhe patriotik i Fadil Hoxhës në zhvillimin dhe konsolidimin e Pavarësisë së Kosovës. Diskursi politik e patriotik i Fadil Hoxhës, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të popullit shqiptar në Kosovë Në

përsëritet për të pranishmit, pas shfaqjes së filmit dokumentar, ish-Presidenti i Republikës, Alfred Moisiu, ndër të tjera veçoi formimin, frymën, qëndrimet, vlerat dhe arritjet e Fadil Hoxhës si udhëheqësi më jetëgjatë i Kosovës, duke dhënë në gjuhë filmike, momentet dhe pasazhet më domethënëse që shërbejnë për plotësimin e shëmbëlltyrës së Fadil Hoxhës, si protagonist kryesor.


Po ashtu, prof. dr. Bujar Kapexhiu – “Nderi i Kombit” e vlerësoi film-in si një narrativë dokumentare me efekte letrarizuese ku dimensionin e liderit kosovar Fadil Hoxha jepet në diskursin e tij politik e patriotik, në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të popullit shqiptar në Kosovë. Rëndësi ka materiali i pasur arkivor e fotografik dhe intervistat që japin rolin bashkëpunues të F.Hoxhës në politikëbërje në mbrojtje të kauzës shqiptare. Skenari dhe materialet filmike, intervistat me personalitetet më të shquara akademike në Shqipëri dhe Kosovë jepen në film në mënyrë estetiko-profesionale me një nivel të lartë, duke përcjellë vlera dhe mesazhe aktuale në dobi të përparimit të shqiptarëve.

Në vlerësimet që bëjnë figurat më të shquara kombëtare akademike, historike dhe publicistike si akademik Rexhep Qosja, Jusuf Bajraktari, Paskal Milo, Nevila Nika, publicistët Veton Surroi, Akif Bajrami etj., përcaktojnë dhe ridimensionojnë figurën dhe rolin e Fadil Hoxhës në historinë e Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore deri në Luftën e UÇK-së, sidomos rolin e tij vendimtar për Kushtetutën e vitit 1974, që e përcaktoi Kosovën krahinë autonome, kufijtë e së cilës shërbyen për shtetin e sotëm të pavarur të Republikës së Kosovës.

Akademik Pëllumb Xhufi evidento rolin e rëndësishëm të Fadil Hoxhës në tejkalimin e prapambetjes kulturoro-arsimore të shqiptarëve në ish-Jugosllavi, arritjet në fushën e të drejtave politike në kuadrin e autonomisë, lirisë dhe të drejtave politike e kombëtare dhe arritjet në Kushtetutën e 1974, përpjekjet në Konferencën e Bujanit për bashkimin kombëtar të shqiptarëve etj. Filmi dokumentar “Fadil Hoxha, arkitekti i Kosovës së lirë” ruan koherencën kontekstuale, mbështetet në inserte ndëraktive që ndërthuren në formë kujtimesh dhënë në mënyrë estetike.

Fadil Hoxha ishte idealist, besonte te liria dhe prosperiteti i popullit të tij Fadili, si shumë djem kosovarë që shkolloheshin në Shqipëri, ishte ndër të parët që përqafoi idetë përparimtare e lirisë dhe të kohës, pasi kishte ndjerë shtypjen e lirive nacionale, nën sundimin e regjimit të egër serb.

Fadil Hoxha, si burrë shteti, me aftësi e dinjitet, me zgjuarsia e largpamësi të jashtëzakonshme, duke shfrytëzuar më së miri konjunkturën e brendshme politike në ish-Federatën



Jugosllave, arriti ta bëjë Kosovën pjesë kushtetuese të Federatës”.

Një ndër gratë më të njohura në kohën e saj, Vahide Hoxha, reformatore e Edukimit dhe aktiviste e shquar, jo vetëm pse ishte bashkëshorte e Fadil Hoxhës, por sepse kreu funksione të shumta, që nga profesoresha e Normales në Prishtinë deri te kryetarja e Bashkësisë së Kulturës. “Sinqerisht them se kam kaluar një jetë të lumtur. Jemi marrë vesh për çdo gjë, kemi qenë si shokë. Prandaj, nuk e kam pasur lehtë që pas 56 vjetësh të ndahem prej tij. Ishte vështirë. Por, jam munduar të mbahem. Në cdo skutë të shtëpisë sime janë kujtimet, që më lidhin me të.”

Me një vështrim realist të kushteve dhe rrethanave historike nëpër të cilat kaloi Kosova, në vitet e thyerjeve të mëdha dhe krizës së pushtetit, janë të rrallë personalitete që u kundërqëndruan sfidave, provokimeve, përndjekjeve, hileve dhe dredhive politike

të panumërta, në mënyrë aq stoike, si Fadil Hoxha. Ai ishte idealist, besonte te liria dhe prosperiteti i popullit të tij, shpresonte dhe ishte i bindur se nëpërmjet Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, si pjesë e Koalicionit Ndërkombëtar Antifashist, do t'i shërbente idealit të kahershëm të popullit të Kosovës – bashkimit me Shqipërinë. Ai ishte iniciatori kryesor edhe për aktivitetin e 500-Vjetorit të vdekjes së Heroit Kombëtar – Skënderbeut (1968); 100-vjetorin të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit (1978), si dy nga ngjarjet kulmore të jetës kulturore e shkencore në Kosovë. Fadil Hoxha pati vizionin e një politikani patriot e modern, i cili projektoi dhe sendërtoi të ardhmen e atdheut të tij.

Fadil Hoxha vdiq më 23 prill 2001 në Prishtinë, në moshën 85-vjeçare.

**\*\*“Mjeshtër i Madh” - Sekretar i Përgjithshëm i OBVL**

## PROFILI

Në respekt e mirënjohje për ushtarakun, gjeneralin e shquar të Ushtrisë Popullore Hysen Ali Shehu - Hormova

# HYSEN SHEHU GJENERAL I SHQUAR DHE KLERIK I LARTË SHQIPTAR

Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI;  
Dr. në proces Robert SHEHU

SHTATË BREZA SHEHLERË  
NË 228 VITE ... HISTORIA  
RIPËRTËRITET NË HORMOVËN  
HISTORIKE

Në bisedë me sheh Hysenin na flet për një "vogëlsirë" në rrugëtimin mistik për një qeramet /Mbrekulli/mistikë fetare, që në fakt këtu fillon zanafilla në breza e Teqesë. Më konkretisht tregon për Sheh Mehmet Cama me origjinë nga Golemi i Kurveleshit, cili në vitin 1798 ka para se të ndërronte jetë thirri rreth vetes më të dashurit e zemrës dhe ju la një testament-amanet: "Unë do të kthehem dhe do të vij përsëri në brezin e shtatë". Në brezin e shtatë i takonte Hysen Shehut pasi Ai kishte para tij gjashtë breza shehlerësh dhe i shtati ishte Hyseni. Edhe vendosja e emrit Hysen ka domethënien e trashëgimisë dhe të linjës së shehlerëve. Sikurse tregon sheh Hyseni kjo u vërtetua, që kur më doli një rrugë në vitin 1987 në Pukë. Kështu me kthimin e demokracisë vendosëm që me nënën dhe me vëllain e madh ta zbatonim në praktikë tesatamentin-amanet. Kështu mori fund karriera ushtarake dhe banimi në Tiranë.kthimi në Hormovë ishte më shumë se një detyrim moral e hyjnor mistik. Kështu kishte vendosur ose paracaktuar Sheh Mehmet Cama që ishte dorëzuar dervish tek Azizi i famshëm i Delvinës. Në kohën kur Ali pashë Tepelena i shpërnguli rreth 850 familjet e krishtera nga Hormova, ndërsa popullsinë për Hormovën me familjet e saj i mori nga fshati i Golemit përtej grykës së Rehovës. Por në këtë zonë edhe më përpara kanë lëvizur dhe ardhur fise nga Golemi dhe fshatrat e tjera në Hormovë. Kështu përmendim fisin "Sinanaliaj", që fillimisht erdhën në Hormovë me gjithë gjënë e gjallë më 1680-ën dhe më tej u vendosën në Fushëbardhë ku janë edhe sot e kësaj dite por që kanë marrë mbiemrin e fshatit Golemi. Në Hormovë mbritën edhe dhjetra fise të tjera që më vonë përbëjnë një komunitet unik fshatçe që në periudha të ndryshme të historisë i dhanë dritë e ndriçim fshatit dhe e bënë të njohur në trevën jugore dhe në të gjithë shqiptarinë. Në pikëpamje historike Teqeja e Hormovës është 228 vjeçare, që i përket një zone me bashkëjetesë ndërjetare në këmbët e malit të Golikut në Tepelenë. Historia i ka mësuar banorët e kësaj treve që të mbijetojnë sipër rrjedhës së Drinos. Vendi ka shumë histori, bëma, trimëri, kapedanë dhe popull i pamposhtur, luftëtarë të lirisë nëpër shekuj. Emërtimi etimologjik është interesant pasi fjala "Hormovë", gjykohet se është fjalë-formuese: "horë" që do të thotë "fshat i vjetër" dhe "ovë" lufinë e vjetër me ujë. Vendasit në Hormovë kanë qenë

• *Hysen Ali Shehu, shtegëton në shtigjet që i hapën shtatë breza dhe me mençurinë dhe aftësinë e tij i dha dritë teqesë së Hormovës në Tepelenë. Hysen Shehu është lindur më 25 shkurt 1941 në Hormovë në një familje atdhetare patriotike e fetare, vendi ku u rrit, u burrërua dhe u fisnikërua në dy drejtime bazë si ushtarak dhe klerik i lartë, u shqua për shëbim dinjitoz si oficer madhor në radhët blerta të Ushtrisë Popullore, por në demokraci edhe si misionar i sukseshëm ku për 32 vite si kleriku më i lartë që kryen detyrën e Kryetarit të Tarikatit Halveti i Shqipërisë.*

dhe kanë ngelur si malet, kontribues në gjithë zhvillimet e historisë. Hormova është edhe martire, edhe fisnike, edhe e rilindur nga përrenj gjaku, edhe sfiduese përballë çdo pushtuesi, edhe luftëtare e paepur përballë dredhive e dhelpërive, por dhe përballë besëpre-reve. Sikurse zakoni i vjetër shqiptar nuk ka honepsur asnjë lloj tradhëtie e pabesie. Sot në Hormovën Halvetjane shërben Sheh Hysen Ali Shehaj, një bir i denjë i Hormovës, një bir vendi që shkëlqeu në radhët e Ushtrisë Popullore, që teqenë e ka trashëgim nga brezi i parë i vitit 1798 kur Sheh Mehmet Cama, erdhi nga Golemi i Gjirokastrës dhe u vendos përfundimisht në Hormovë. Më tej jeta e këtij oxhaku me rrënjë shehlerësh ka rrjedhur si ujë e burimeve të Hormovës që janë në gjashtë breza: Sheh Isuf Hormova (1820 - 1855), Sheh Meleqi (1854 - 1872), Sheh Xhaferi (1872 - 1900), Sheh Veipi (1900 - 1914), Sheh Aliu (1936 - 1967), dhe që nga viti 1994 e në vijueshmëri Sheh Hyseni. Nga ana tjetër Hormova ka edhe historinë e saj të dhimshme të masakrave dhe gjakut të derdhur. Në vitin 1787 kur Ali Pasha masakroi në Manastirin e Shën Triadhës në Tërbuq 200 burra hormovitë dhe kapedanin Çausht Prifti (Dhim-itër Prifti, përmendet dhe me emrat Mitro, Spiro e Thanas, prandaj dhe kënga thotë "Hormovitë kapedanë,/kishin Çaushtin të parë,/Çausht i biri i Marisë, Kapedan i Shqipërisë,/kasap i turqërisë.."). Më 29 prill 1914 andartët grek masakruan 217 burra e djem hormovit, një histori që nuk harrohet.

## GJENERALI QË LA GJURMË TË THELLA SI MËSIMDHËNËS, DREJ- TIM E KOMANDIM

Hormova ka nxjerrë mjaft figura në shumë fusha të jetës, por nuk ka ngelur prapa edhe në prijësia, drejtues e kapedanë, ndërkohë që në gjysmën e dytë të shekullit të XX, fshati ka njohur Gjeneral Ethem Gjinueshi, Gjeneral Hysen Shehu, Begë Murat Tena dhe shumë të tjerë. Gjeneral Ethemin e njohin që nga Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare që bëri emër dhe lartësoi emrin Hormovë, ndërkohë që bashkëkohës të Hysen Shehut si oficer në perfeksion, me njohuri të thella, me kulturë mjaft të gjerë, orator polidrik, rreshtor i pakrahasueshëm, me kulturë teorike të plotë dhe me



dije teorike e praktike si rrallëkush, ja ngriti më tej supet jo vetëm Hormovës, por Tepelenës dhe jugut e deri në veri në Pukën e tij që e dashuroi vendin e punës kudo që ishte. Shkurt shkëlqente me mirësinë dhe rregullsinë, me argumentin e thellë me veprimet praktike të jashtëzakonshme, thjeshtë oficer brilant në këndshikimin studentor. Në Hormovë dhe jo vetëm të flasin edhe Kush nga studentët e Shkollës së Lartë të Bashkuar nuk do donte që ta imitonte? Qindra studentë donin të bëheshin si Ai, të komandonin dhe drejtonin si Ai dhe mbi të gjitha të kryenin veprimet praktike ushtarake si Ai. E thënë shkurt, Hysen Shehu ishte një edukator i përkryer që meritonte të imitohej për dijen, horizontin kulturor dhe veprimin praktik. Hysen Shehu ishte një shkollë më vete, me vlerë sa një institucion që kushdo që e ka njohur nuk mund ta harrojë asnjëherë. Por shumëkush edhe në moshën e pjekurisë dhe mençurisë në Hormovën historike e ka njohur për atë çfarë është, për lezetin e vendit, filozof dhe atdhetar, për njerëzillëkun për familjarin shembullor dhe për humanizmin dhe që u qëndron pranë njerëzve. Hysen Ali Shehu është lindur në Hormovë, më 25 shkurt 1941 në kohë pushtimi. Ai erdhi në jetë në një familje sa patriotike aq edhe fetare në breza shehlerë. Arsimin fillor e kreu në vendlindje në vitin 1951, shkollën unike në Tepelenë 1951 - 1954. Në vitin 1954 u regjistrua në Politeknikumin "7 Nëntori" Tiranë, pas përfundimit të së cilës në vitin 1958 punoi dy vjet në Uzinën Mekanike Tiranë si tornitor, teknik i mesëm. Në vitin 1960

i etur për dije, por dhe për nevoja të përgatitjes së djelmohave më të aftë të Shqipërisë për mbrojtje, dërgohet në Shkollën e Bashkuar të Oficerave që duhet thënë se kjo shkolla ka qenë gjithmonë shkollë burrërie. Në këtë rast nuk kishte zgjedhje, kishte vetëm planifikim, që në një farë mënyre ishte e urdhruar vendi ku do të studioje dhe ku do të punojë. Pasi përfundoi Shkollën e Bashkuar me rezultate të shkëlqyera në specialitetin "Artileri Tokësore" me medalje ari, por edhe me gradën më të lartë të kohës, "Toger" (një gradë më të lartë se shokët e tij të grupit mësimor). Për aftësitë e tij u emërua pedagog në Shkollën e Bashkuar ku shërbeu 22 vjet. Gjatë viteve 1971 - 1973 përfundoi Akademinë e Lartë Ushtarake në Tiranë, me medaje të artë. Në vitet 1981-1983 kreu kursin e lartë të filozofisë në Tiranë. Emri Hysen Shehu rreshtohet me ato kuadro që kishin mbaruar me këtë vlerësim që nga koha e krijimit më 10 maj 1958 (në rajonin e Rrapit të Treshit). Fakt është se pas përfundimit të studimeve më të larta në vend në korrik të 1973-it rikthehet në Shkollën e Bashkuar të oficerëve si pedagog dhe në vitin 1974 emërohet Shef i degës mësimore dhe Zv/Komandant i Shkollës së Lartë Bashkuar (me Urdhër të MM nr. 1453 dt 7.4.1975 dhe pas ristrukturimit sërish me urdhër nr. 2709 datë 16.10.1980 me pagesë 1000 lekë në muaj). Gjatë kësaj kohe ka bërë një punë pasionante, jo vetëm si autor tekstesh mësimore për shkollën dhe ushtrime por edhe në ndërtimin e kabineve mësimore për studentët. Emrin

(Vijon në faqen 13)

## PROFILI

*Në respekt e mirënjohje për ushtarakun, gjeneralin e shquar të Ushtrisë Popullore Hysen Ali Shehu - Hormova*

# HYSEN SHEHU GJENERAL I SHQUAR DHE KLERIK I LARTË SHQIPTAR

(Vijon nga faqja 12)

e tij e gjejmë në tekste mësimore, materiale metodike, rregullore të karakterit ushtarak. Për aktivitetin e tij të dendur edhe si penë e fuqishme e kohës Hysen Shehu me meritë bëhet anëtar i Këshillit Shkencor Ushtarak pranë Ministrisë së Mbrojtjes nën drejtimin e Shefit të Shtabit të Përgjithshëm Veli Llakës nga Krahësi i Memaliajt. Edhe në këtë detyrë u shqua për kontribut në zbrërthimin e Artit Ushtarak Popullor, që për kohën ishte pasaporta shqiptare e mbrojtjes një garant i sigurtë për Shqipërinë dhe shqiptarët. Konsideracionet për brezin e studentëve të viteve '80-të janë të shumta, pasi studenti e lexon mirë, e ndjek, mëson prej tij dhe e imiton në rrugëtimin e karrierës. Nuk ka student që ka përfunduar shkollën e Bashkuar dhe nuk ka përfutuar nga dijet e tij, nga kultura, nga argumeti, nga filozofia, nga prakticitet, nga rreshtori i klasit më të lartë, që kur parakalonte i lëshonin këpucët xixa si të ishin prej stërralli. Në fakt ai ishte dhe mbeti një burrë i stërralltë në mendime, në gjykime, në arsytetime, një aftësi e mençuri e lindur që dinte edhe të bënte rreshtore e veprime perfekte me armë edhe në tribunën e ceremonialit të rreshtimeve të Shkollës së Bashkuar. Ai nuk përtonte të kalonte në çdo grup mësimor dhe të bëhej shembulli udhërrëfyes duke turpëruar edhe shumë të tjerë që ndoshta i rrëmbente për një çast vetkënaqësia e rutina. Është kjo arsyeja që studentët e donin e respektonin, mbanin frymën kur ai kalonte, nderohej njësoj si madhorët e tjerë të drejtimit dhe të komandimit, krahas Rustem Peçit e Novruz Sakos, Islam Haxhisë, Enver Kapxhiut, Peti Çalës, Sali Xhakupit, Pilo Panos, e shumë të tjerë. Në vitin 1985 pas mbi dy dekada në funksionet si pedagog, shef i Degës mësimore, Zëvendëskomandant të SHLBO "Enver Hoxha", me urdhër të Ministrit të Mbrojtjes Popullore nr. 32 datë 29.6.1983 emërohet Komandant i Shkollës së Instruksionit të Divizionit 17 të Këmbësisë së Pukës. Kjo edhe për debatet me Prokop Murrën më 1985, ndërkohë që lufta e bërrylave ka ekzistuar gjithmonë. Më tej me ndryshimet demokratike evropiane e për rrjedhojë edhe shqiptare më 17 dhjetor 1990 e vendosin në dispozicion të Divizionit të Këmbësisë së Tiranës (Urdhëri nr.81 datë 17.12.1990), në Br150K Tiranë, shef Artilerie Urdhër i MM nr. 2461 datë 24.1.1991, ndërsa përgatitej reforma absurde e kohës e nxorri në lirim me urdhër të MM të datës 2.7.1992, ndërsa të drejtat financiare i ndërpriten më datën 20 korrik 1992. Nxjerrja në lirim në një moshën 51 vjeçare, ishte akt që natyrshëm Hysen Shehu nuk e priste, sepse ju mbyll dera e gjithë investimit dhe aktivitetit shkencor për ushtrinë, djersa dhe munda i viteve të tëra studimesh i "hëngri reforma" e një grusht njerëzish gjoja demokratë. Ishte një nga

veprimet më negative që nuk i kryenin vetëm ndaj njerëzve të mençur dhe me integritet që kishte ushtria, por një veprim i nxituar i shtetit kundër shtetarëve të vërtetë. Fakt është se nën maskën e reformimit fshinë me veprime negative gjithçka të mirë që ishte krijuar. Guri kishte filluar të rrokullisej dhe ende nuk po ndalet. Mënyra se si po zbatohet "reforma" ku mjaftë kuadro me nivel të lartë dhe dije shkencore, u mënjantuan me pretekstin se gjoja janë të vjetër, kur shumica nuk e kalonin të 50-tat ndërsa ata që "i kërkonte vendi" u mbajtjen ishi mbi 60 vjeç, por dhe profesionalisht të pa aftë që nuk mundën ta çonin përpara reformat e modernizimin e Ushtrisë dhe për më keq sollën edhe 1997 që vet shtetin e dërguan drejt greminës. Natyrshëm në këto kushte Hysen Shehu një shtetar i zoti dhe tepër i aftë ju bind zbatimit të vendimeve të qeverisë dhe konkretisht, nuk zgjodhi rreshtimin me pensionistet por shkoi në genin e tij dhe të brezave që e mëkuan me atdhedashuri dhe me dashuri për besimin edhe pse për tre dekada besimi në Shqipëri u ndalua me ligj. Kishte ardhur një epokë e re dhe zgjedhja e rrugëtimin jetësor kërkonte energji, mençuri dhe besim, që natyrshëm këto Hysen Shehut nuk i munguan asnjëherë. Në dosjen personale të oficerit madhor Hysen Shehu gjejmë edhe gjurmë të vlerësimeve sikurse janë dekoratat ushtarake si "Medalja e shërbimit Ushtarak" me nr. 4563 të datës 1.11.1969, Urdhëri "Ylli i Kuq" nr.5755 datë 29.6.1978 etj, por medalja më e madhe është vlerësimi popullor si dje si ushtarak edhe sot si kryetar i tarikatit Halvetli të Shqipërisë.

## **"BËMË BABA TË TË NGJAJ", NJË MAKSIMË PROVERBIALE POP- ULLORE SHQIPTARE PLOTËSISHT E VËRTETË**

Hysen Ali Shehu ka qenë në moshën moshën 11 vjeçare kur është njohur dhe brumosur me ritet dhe praktikat fetare nga babai i tij Ali Shehu. Sheh Aliu Hormova ka qenë mjaft i njohur në fshatin Hormovë dhe në krahinë por edhe më gjerë. Ai ishte kryetari i tarikatit Halveti të Shqipërisë nga viti 1950 e deri më 1967 vit ku feja u mbyll nga shteti me Dekretin me nr 4337 date 13 Nëntor 1967. Dekret i Presidiumit të Kuvendit Popullor nr 4337 date 13.11.1967, "Për mbylljen e besimeve", Shqipëria u shpall zyrtarisht shteti i parë dhe i vetëm ateist në botë dhe në histori që ndalonte çdo shprehje të fesë. Presidiumi i Kuvendit Popullor të RPSH çfuqizoi Dekretin nr.743 datë 26.11.1949 "Mbi komunitetet fetare" dhe dekretin nr.1065 datë 4 maj 1950 të Presidiumit të Kuvendit Popullor për statutet fetare. Duket se ka një diçka mistike me moton e "iluminatit", data e ndalimit të besimeve që në fakt është një kombinim numrash (17)76 me majin e (19)67 kur ndalohen besimet fetare në Shqipëri (Fletore Zyrtare, viti 1967; Dekret 4337

dt.13.11.1967 (76-67=13). Iluminati numrin 13 e lidh me dhjetra ngjarje. "Iluminati", zakonisht lidhin me shekujt 16,17, 18-të me "Alombrados" më 1575 në Spanjë të përsëritur në Sevillja më 1623 dhe 1627 me mistikët në Belgjikë e guerinets në Francë, në Bavari të Gjermanisë etj ku misticizmi shpesh është i habitshëm dhe kërkon logjikë të fortë në shpjegimin iluminat dhe hyjnor. Një nga korifenjtë e mençurisë mistike është padyshim Baba Rexhepi (18.8.1901 lindur në Gjirokastrë dhe është shuar më 10.8.1995 në Detroit, SHBA). Baba Rexhepi themeluesi i teqesë së parë bektashiane në Taylor, Miçigan të SHBA-së, ishte i biri i Mulla Refat Beqirit në librin "Misticizma Islame" thekson: "Grupi i Halvetizmës lidhet me grupin e Xhunejdi Bagdatiut, mistikut të madh të shekullit të shtatë të Hixhretit. Pir Omer Halvetiu e mori dritën mistike të tarikatit të tij nga Ebu Muhammed Bin Nuri Halvetiu". Halvetizmi konsiderohet një nga tarikatet Alvinjë i cili përmbledh në gjirin e tij një grup të madh tarikatësh si: Nureddin, Bajramizmin, Xhilvetizmin, Gjylshenizmin etj, etj. Halveti nënkupton tërheqjen në vetmi, që realizohet në mënyrë periodike, ku ky angazhim realizohet në dyzetë ditë në një vend të mbyllur. Halveti është dy llojesh: i brendshëm dhe i jashtëm. Teqja e parë halvetjane në trojet shqiptare u ngrit në Artë dhe pas saj në Delvinë, Plesat, Bënçë etj. Ndërsa teqja halvetjane e Hormovës, u ngrit me anë të një bujurdi të Ali Pashës në vitin 1798 dhe me bekim të azises së Delvinës, në të cilën shërbente mistiku halvetian Sheh Mehmet Cama (Golemi) dhe që kishte fituar besimin e Pashait të Janinës. Sheh Meleqi ishte kleriku që gëzonte respektin jo vetëm të popullsisë myslimane, por dhe asaj të krishter. Për këto vlera bamirsi labovit Vangjel Zhapa kontribuoi në ndërtimin e Xhamisë pranë teqesë së Hormovës. Midis klerikëve të teqesë ka edhe shehit (dëshmor) të Atdheut, siç është martiri Sheh Veipi, masakruar prej andartëve grek në vitin 1914. Në rrugën e Atdhetarisë dhe të përkushtimit ka ecur edhe Sheh Hyseni në rrugëtimin e misticizmit islam si dhe mësimave kuranore dhe fjalëve të profetit. Kultura ushtarake dhe kultura fetare kanë rritur një bir hormone që kërkon gjithmonë e më shumë më të mirën e njerëzimit, në të mirë të mbarë komunitetit dhe të përparimit të kombit shqiptar.

## **BABAI I HYSEN SHEHUT, SHEH ALIU DIELL ME NDRICIM TË PËRHERSHËM, NJË MAL DITURIE**

Sheh Ali lindi në Hormovë, më 23 prill të vitit 1902 dhe ndërroi jetë më 7 nëntor të vitit 1984. Në fshat, krahinë, Tepelenë dhe gjithë vendin njihet si një atdhetar, mësues, intelektual, klerik, luftëtar lirie, administrator, udhëheqës shpirtëror i tarikatit Halveti, por edhe publikues, burrë orator i kuvendeve dhe mexhliëve. Fakt është se nga të



dhënat Sheh Aliu dallonte në veprimtari atdhetare e patriotike. Ai ja doli jetës me forcat e veta pasi babai i tij Sheh Veipi u vra nga andartët grek të vitit 1914. Ali Shehu ishte 12 vjeç kur hallet i ranë përsipër por nuk e gjuhëzuan, por që në moshën 14 vjeçare u lidh me lëvizjen kombëtare shqiptare. Kështu nga të dhënat e Profesorit të historisë të Universitetit të Gjirokastrës Shyqyri Hysi, rrezultonte se, Ali Shehu ka shumë momente të spikatura në veprimtarinë e tij: "Në vitet 1916 - 1921 shkoi në Izmir ku mori asim, kulturë dhe edukim fetar. Ndërkohë hapi shkollën e parë shipe dhe shërbeu si mësues në fshatin Hormovë në vitet 1921 - 1923, më tej ka qenë mësues në fshatin Damës në vitet 1928 - 1929; kryetar komune në Zharëz të Fierit, Breg të Matës Lezhë dhe Therepel të Skraparit në vitet 1930 - 1935. Një vit më vonë më 1936 shkollën klerik në fshatin e lindjes në vitet 1936 - 1942 dhe në vitet 1944 - 1950. Në vitet 1942 - 1944 u rreshtua në radhët e formacioneve luftarake partizane të UNÇSH. Në vitin 1944 Sheh Aliut ju akordua grada ushtarake "nënkolonel", por nuk e mbajti për arsye fetare. Në vitet 1950 - 1967 drejtoi Tarikatit Halvetian të Shqipërisë, ku ka mundësuar edhe katër botime me karakter klerikal, letrar e historic si: "Masakra", "Era e Sabahut", "Këshilla e të urtit" dhe "Përelma perdenë". Ai ishte njohës i pesë gjuhëve të huaja dhe i përdorte ato me mençuri. Kushdo që e ka njohur sheh Aliun ka dalluar viti të spikatura të karakterit, njeri i vullnetshëm, i duruar, largpamës e vizionar si dhe urtësi e zgjuars natyrale, që me atdhetarinë e patriotizmin e kompletojnë figurën e një kleriku të mençur. Në vlerësimet për Sheh Aliun, për veprimtarinë atdhetare, mësimdhënëse por edhe si klerik i njohur është dekoruar nga Kuvendi Popullor me medaljen e Kujtimit, Çlirimit dhe Trimërisë. Qarku i Gjirokastrës e ka vlerësuar duke e shpallur "Nderi i Qarkut" të Gjirokastrës.

(Vijon në numrin e ardhshëm)

## LIBRI

## INDRIT CARA-KAVAJA, DËSHMOR I KOMBIT

*Bie në luftë për liri, në dheun e Dardanisë. 31 mars, 1999*

KADRI TARELLI

**P**ara pak ditësh, më: 23, të Marsit 2026, erdhi në Durrës, z. Muharrem Shqarri, koleg në arsim dhe në krijimtari letrare, kryesisht studime historike. Kemi disa vite që njihemi, këmbëjmë vizita dhe natyrisht edhe libra e krijime.

U ulëm në kafe në sheshin para Postës së Durrësit, ku me ne u bashkua edhe shkrimtari e publicisti i njohur Shpendi Topollaj. Natyrisht, si fillim, bisedat e para u rrotulluan rreth shëndetit.


Muharremi nuk më la të mendohesha gjatë, pasi hapi çantën, nxori librin kushtuar Dëshmorit të Kombit, Indrit Cara-Kavaja. – “Jeni një grup durrsakësh pjesë e këtij libri”, - dhe po lexon: - “Dera e Carave pret ngushëllime”, dhe më tej vazhdoi: - Më, 15. 04. 2000, “Fondacioni “Sulejman Vokshi”, kryesuar nga Qazim Kreka, kryetar, Salvator Sotiri, sekretar, dhe Kadri Tarelli, anëtar, nderon me “Fletë nderi” Indrit Carën. Faqe 185.

Pse ta fsheh, më erdhi mirë që kjo ngjarje nuk paska mbetur pa lënë shenjë. E quaja të harruar pas 26 vjetësh, ndaj i përgjigjem duke shtuar:

- Po kemi qenë në shtëpinë e Indrit Carës, në Kavajë, fill pas një viti nga rënia e tij. Na pritën prindërit e Indritit, të cilët ende nuk ishin mësuar me dhimbjen, ndonëse jam i bindur se asnjë ditë nuk kanë kaluar pa pasur vizita në shtëpi, nga miq dhe të njohur, luftëtarë, shtetarë e pushtetarë nga vendi dhe Dardania, madje edhe nga mërgimtarët tanë të shpërndarë në mbarë botën”.

Këtu më duhet të shtoj, se në po të njëjtën ditë, më 15. 04. 2000, shkuam edhe në qytetin e Kuçovës, te familja e dëshmorit Astrit Suli, edhe ky i rënë në luftë për lirinë e Dardanisë.

Duke e parë librin me një lloj këshërie të shtuar, e zgjas bisedën time: - Sa mirë bëre.....! Do ta lexoj më nge dhe të bëj një shkrim, pasi po më pëlqen si formë, pa dyshim edhe si përmbajtje. Muharremi më kujtoi se, 31 marsi, 1999, është dita e rënies, pra mbushen plot 27 vjet. Kështu po ngutem të lexoj e të vlerësoj dhe të shkruaj mbi këtë libër “Monografi”, me peshë të madhe në atdhetari e shqiptari.



Në fakt janë shkruar shumë libra, nga autorë të ndryshëm, ku secili ka dhe tregon vlerat e veta, duke derdhur të gjithë mjeshtërinë e fjalës dhe krijimtarisë. Por kam përshtypjen se libri i i Muharrem Shqarrit, më duket si më i ploti, më i pjekur, më i arrirë, më cilësori, duke hyrë në shpirtin e intervistave dhe dokumenteve të vendosur aq imtësisht në libër.

Nuk kam ndërmend të analizoj përmbajtjen, pasi çdo këndonjë (si puna ime), ka çfarë të mësojë nga jeta dhe veprimtaria e heroit tonë Indritit: Fëmijërinë, Shkollën e Bashkuar Ushtarake “Skënderbej”, Tiranë. Më pas emigrimi në Itali, duke përfunduar në Britani të Madhe.

Autor Shqarri, kësaj periudhe i kushton një vëmendje të veçantë. Ngjarjet në Dardani, si rezultat i spastrimit etnik që ndërmoret pushtuesi serb, ndaj popullsisë autoktone shqiptare e preken shumë. Ishin mijëra shqiptarë që lanë pasuri, shtëpi e katandi për t'i shpëtuar shfarosjes. Ishte heroizmi i Adem Jasharit që ndezi zemrat e të rinjve shqiptarë. Ishin këta të rinj nga Dardania që krijuan UÇK-në, si forcë reale ushtarake, që u ngrit në luftë duke u ndeshur me armikun serb. Ishin mijëra të rinj shqiptarë nga mërgimi, që u nisën vullnetarë në njësit ushtarake të UÇK, ashtu si edhe Indrit Cara, që dhanë jetën për liri, duke mbetur në altarin e kombit. Ishin këta të rinj që u bashkuan me fuqitë e botës për të çliruar Dardanië shqiptare.

Në luftë shkohet për të vlarë, ose për t'u vlarë, me synimin për fitore, me shpresë se, ai dhe kombi i tij do ta gëzojnë mundin dhe gjakun e derdhur. Të gjithë duan të festojnë lirinë, por jo të gjithë e arrijnë, duke rënë dëshmor për dheun dhe mbi dheun e të parëve, duke mbetur në histori.

Kështu, cilido nga ne, natyrisht bën pyetjen: - Si është e mundur që Indriti dhe ata mijëra vullnetarë, lanë punën dhe mirëqenien, që me aq mund e patën krijuar dhe u nisën në front, pa e menduar se mund të mos ktheheshin. Një idealizëm për t'u admiruar dhe për t'u marrë shembull frymëzimi.

Natyrisht nuk është rasti i parë dhe as i vetmi në historinë shekullore e popullit tonë, madje edhe të popujve të tjerë. Historia është e mbushur me raste të tilla, por po ndalem në këtë përjasje kaq madhore, me pyetjen: Si lind e ku lind ky heroizëm, si trashëgohet e përcillet ndër breza.....!?

Pa hyrë në sinorët e psikologjisë, po them se këto ndjesi të forta për

atdheun dhe kombin, kultivohen në gjirin dhe traditën e familjes, në mjedisin e fisit, fshatit apo qytetit. Përforcohen në bisedat në “Odën e burrave”, me edukimin në shkollë nga mësuesit pasionantë, veçanërisht të historisë dhe letërsisë, duke sjellë shembuj që i bëjnë jehonë këtyre ngjarjeve kaq madhështore në jetën dhe veprën e heronjve, që shpërthejnë në kohë, popuj dhe vende të ndryshme.

Si njohës i historisë, mund të mbush faqe të tëra shkrimtarie, por për “Heroin” tonë, po përmend një ngjarje që ka ndodhur në fisin e Carave nga qyteti i Kavajës. Është fjala për Ministrin e financave Dr. Et'hem Cara, që mbrojti thesarin e shtetit, kur Shqipëria ishte ende e pushtuar, tetor 1944. Atëherë, kur jeta nën sundim kushtonte shumë pak.

- “Fëmijët i dua, por interesat e atdheut nuk i shkel...!”. - Duke i thënë “Jo”, komandantit ushtarak gjerman, i cili nguli këmbë për të marrë disa qindra mijë “Napolona flori”, nga thesari i shtetit shqiptar. Natyrisht për shpenzime ushtarake”. Kështu shprehet Bashkim Kadiu, në librin: “Trashëgimia e vlerave në Olimpin e qytetarisë durrsake”. 2025.

A nuk meriton një përmendore në një shesh të Tiranës, Ministri, që tha dhe i qëndroi besnik fjalës së tij...!? A duhet vlerësuar ky qëndrim, si shembull i ndershmërisë së këtij nëpunësi shqiptar. Fjala pa vepra nuk ka rëndësi. Vepra është dhe mbetet në përjetësi. Besoj se vetëm këto pak fjalë mjaftojnë për të thënë se heroizmi nuk lind në truall të shkretë. Veprimi e tij është dhe mbetet shembull që na nderon, por që na mungon në ditët e sotme. Model që mbetet në kujtesë për të mos u harruar. Model që frymëzon për t'u ndjekur nga të rinjtë. Kumti që përcjell është i thjeshtë: Mos ankohemi se nuk kemi modele të guximit, trimërisë, ndershmërisë, atdhetarisë dhe qytetarisë.....! I kemi dhe i gjejmë nesh, të vjetër dhe të rinj.

Autori Muharrem Shqarri, si studiues dhe krijues, është përpjekur të jetë sa më pranë lexuesit, mundësisht të hyjë në bisedë me ta duke i marrë përdore duke i rrëfyer vlerat njerëzore dhe atdhetare të heroit Indrit Cara. Ai me një rrëfim të rrjedhshëm, gjuhë të thjeshtë, pa zbulime, siç i takon një libri me temë historike, shpreh mendim të qartë e të kuptueshëm, të krehur bukur nga fjalët e tepërta, përfshi edhe fjalët e huaja.

Një vlerë e shtuar e këtij libri është përmbledhja e të gjithë autorëve të librave dhe shkrimeve në

• “Shqiptarët janë njerëz të tillë, që më mirë vdesin, sesa të kërkojnë, më mirë mbarojnë në dëshpërim të vet, sesa të qahen... Ata janë popull tragjik, por një racë heroike”.

*Herman Bernstein.  
Ambasador në Shqipëri.  
1930 – 1933.*

revista e gazeta që janë botuar për Indrit Carën. Më tej sipas alfabetit, lista e emrave të përmendur, në libër. Diçka e veçantë, por e bukur.

Nuk e teproj të vë në dukje albumin në fund të librit, me një renditje të admirueshme që nga lindja e deri te busti i ngritur në qendër të qytetit e Kavajës dhe në Dardani, në shenjë nderimi dhe përjetësimi të gjakut dhe veprës së “Dëshmorit të Kombit”, Indrit Cara.

Si mësues i vjetër, që e ngrysa jetën në arsim, më duhet të shpreh një mendim që po e bluaj prej kohësh: Nuk them kush duhet ta marrë përsipër, por strukturat shtetërore të arsimit kanë mundësi të mendojnë dhe të hartojnë broshura të vogla me “Heronj”, si përmbledhje me figura të tilla me vlera shqiptarie, në ndihmë të shkollave dhe mësuesve. Kam shkruar edhe diku tjetër: - “Më vjen keq, që shumë herë, mjerisht dhe fatkeqësisht, marrim si borxh “heronj” nga historia e popujve të botës, kur ne kemi aq shumë figura të ndritura nga gjaku dhe rrënjët tona, jo vetëm të rënë në luftë për liri, por në të gjitha sektorët e jetës dhe veprimtarisë njerëzore e shoqërore”.

Duke kursyer përsëritjet, që janë të panevojshme, po përmend vetëm këto pak vargje, vendosur në kapak të pasmë të librit:

## BASHKËMOSHATARËVE

“Thotë gjaku mos harro,  
Moshatarët që nga plumbat bien!  
Është ky gjaku, trëndafil lirie.  
Dritë shprese për atdheun,  
kush ngrihet.....!  
Drejt të ardhmes ti vrapo,  
se zjarr ke zemrën,  
Flamur ke këngën.  
Bashkohen zemrat si vargmal.  
Ku ndrin një ideal.....!”

Indrit Cara, heroi i luftës për liri, në Dardani, mbetet i përjetëshëm në histori dhe do të kujtohet në mijëra vjet përjetësi.

Mirënjohje dhe nderim edhe për ju Muharrem Shqarri, autor, shkrimtar e studiues, që kaq vërtetësisht, si model frymëzimi, na sillni jetën dhe veprën e heroit Indrit Cara.

Jam i bindur se libra të tjerë studimore, do të zënë vend në tavolinat dhe bibliotekat tona.



## TAKIMI

# PSE E NDËRPREU BRESHËRINË AUTOMATIKU i Skënderbegasit INDRIT CARA mbi PUSHTUESIT SËRB...???



## Kolonel Trifon Llupo\*

Më 31 Mars 2026, Shoqata "Shkolla Ushtarake Skënderbej", organizoi një ceremoni perkujtimore në nderim të rënies në fushën e betejës të ish skënderbegasit 28 vjeçar, Indrit Lulzim Cara nga Kavaja.

Në këtë aktivitet perkujtimor morën pjesë 13 anëtar të Shoqatës ish skënderbegas të dhe 4 studentë nga Kosova që përgatiten në Akademinë Ushtarake të Forcave të Ar-

bej" ishin marë shumë të plota nga kryetari Av. Adem Ajdini, duke na dërguar edhe plan-kalendarin e pritjeve dhe aktiviteteve, duke filluar me kërkesën drejtuar Ministrisë Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm për vënien në dispozicion një mjet transporti për 17 pejmarrës, pasi në grup do ishin edhe 4 student të Akademisë Ushtarake nga Kosova, kërkesë e cila u plotësua nga Ministria e Mbrojtjes dhe Shtabi i Përgjithshëm e Forcave të Armatosura dhe në orën 05:30 të mëngjesit të datës 31 marsit

nazistë, generali, Heroi i Popullit dhe Nderi i Kombit, Rrahman Parllaku, i cili edhe është plagosur për herë të dytë, gjatë luftimeve këtu në Kosovë dhe tani ka nderin ta drejtojë OB-VLP, vajza e gjeneralit Parllaku zonja Tatjana Çakërxiu(Parllaku).

Kryetari i komunës shprehu vlerësimet dhe respektin për perkujtimore për Heroin e Kosovës dhe të Shqipërisë, Indrit Cara, duke përsëritur ftesën për pjesmarrjen në drekën që do shtrohej nga Komuna

Suharekë e bashkëluftëtarë të heroit Indrit Cara e pastaj u nisëm për në Fshatin Petershtec, ku ishte vendosur Batalioni II-të "Ruzhdi Salihu". Në orën 14:30 mbërritëm në fshatin Petërshtec, ku na priste Shtabi Batalionit me komandant Ramiz Çeriqi (kom. Luani) dhe kur mbërritëm atje, i gjithë Shtabi kishte dale ke shkallët e hyrjes në Batalion dhe, ne u përshëndetëm e duke na shtërnguar duart vëllezërit tanë të një gjalu e të një Flamuri.

Një diçka shumë e veçantë ishte pritja në Odën e Batalionit, e cila ishte e shtruar më qilima tradicional e me me shilte rreth e qark, ku u ulëm të gjithë ne, sëbashku me Shtabin e Batalionit.

Komandant Ramizi (Luani) na njohu me rrugën luftarake të Batalionit, me ish efektivët që kishin dhënë jetën për çlirimin e Kosovës, dhe kuptohet në mënyrë të veçantë na foli për Heroin e Kosovës dhe të Shqipërisë Indrit Cara, i cili u largua nga Londra, ku banonte e punonte dhe u rreshtua në radhët e Luftëtarëve me Stemën historike -UÇK-, të cilën e kanë gjithë pjesmarrësit në këtë luftë heroike.

Pastaj u shtrua Dreka për Nderimin tonë në këtë Ceremoni perkujtimore, edhe këtu ishte e veçanta e kesaj dreke, që nuk u ulëm në karrike e tavolina por, sipas traditave të vjetra shqiptare ne Sofrën rrumbullake siç dukemi në fotot e bëra në këtë drekë, e cila u shoqërua edhe me këngët patriotike për ushtrët e rënë në këtë luftë, të ekzekutuara me mjeshtëri artistike nga 4 rapsodët e Batalionit, duke i shoqëruar edhe me të shtënat e nja 20 fishekëve me pistoletë, për të sjellë në vëmendjen tonë ato krisamt e kesaj Luftime të UÇK-ës.

E pas kesaj dreke shumë të pasur me prodhime të fshatit, erdhi edhe fundi i kesaj Ceremonie perkujtimore e Heroit të Kosovës dhe të Shqipërisë, Indrit Cara, duke bërë edhe shumë fotografi me vëllezërit tanë të Batalionit "Ruzhdi Salihu" dhe morëm rrugën e kthimit për në Tiranë, duke mbërritur aty nga ora 21:00.

**\*Ish skënderbegas & N/kryetar i OBVLP**



matosura, organizuar nga kryetari i Shoqatës Av. Adem Ajdini.

Kjo ceremoni është vendosur të organizohet nga Bashkia e Kavajës dhe Komuna e Suharekës çdo vit, me rotacion, një vit në Kavajë dhe vitin tjetër nga Komuna Suharekës dhe, këtë vit vendi mikrpritës ishte Komuna e Suharekës.

Stafi i Bashkisë Kavajë u kryesua nga nënkryetari i Bashkisë z. Genci Gjylsheni.

Në këtë ceremoni mori pjesë edhe Organizata e Bashkuar e Veteranëve të Luftës të Popullit Shqiptar e Pasardhësve (OBVLP), e përfaqësuar nga n/kryetari i OBVLP, kolonel Trifon Llupo. Masat organizative për pjesmarrjen e Grupit të Shoqatës "Shkolla Ushtarake Skënder-

mikrobuzi komod shkoi në të gjitha pikat e takimit dhe u nis në drejtim të Rrugës Kombit, i cili në orën 08:50 kaloi kufirin Shqipëri-Kosovë dhe mori rrugën për në Suharekë, ku ishte lënë takimi i parë i pritjes nga pushteti vendor.

Në orën 10:45 na priti në zyrën e tij, kryetari i Komunës së Rahovecit. z. Bali Muharremaj,

Mbas takimit me kryetarin e komunës ku, unë iu prezantova se përfaqsoj Organizatën e Bashkuar të Veteranëve të Luftës të Popullit Shqiptar dhe të Pasardhësve (OBVLP), duke i spjeguar me disa fjalë shkurt për misionin e OBVLP, të cilën e ka drejtuar për 20 vjet, ish komandanti i Divizionit të 5-të., që ka marë pjesë në çlirimin e Kosovës nga pushtuesit

Suharekë por, Av. Ademi e falenderoi për ftesën dhe e informoi se grupi i skënderbegasve do të ishte për drekë në komandën e Batalionit II-të, te komandant Ramiz Çeriqi, i njohur gjatë Luftës me emrin "Luani", i cili i kishte dhënë "urdhër" si kamundant i Batalionit II-të që një ditë më parë, se për drekë do jëni këtu tek ne, në fshatin Petershtec, ku është i dislokuar Batalioni II-të, me emrin "Ruzhdi Salihu", emir i dëshmorit të parë "Ruzhdi Salihu".

Pastaj vazhdoi aktiviteti në Shtëpinë e Kulturës "Ukë Bytyçi" e më pas u nis kolona me makinat Fuoristrade për në Malin e Golloshit, ku ngrihet Lapidari i Heroit Kosovës, Indrit Cara, ku folën përfaqësues të Bashkisë Kavajë dhe të Komunës

## PËRURIMI

# OVLP URON VETERANIN GENÇ BALLANCA NË 97-VJETORIN E DITËLINDJES

- *Për një kohë të gjatë, kreu me sukses të plotë, detyrën e Kryetarit të Degës për Durrësin, ku u tregua i pa lodhur dhe përherë i përkushtuar. Dega e OBVL - së në Durrës, nën drejtimin e tij u dallua për organizimin e shumë veprimtarive dhe shtimin e radhëve të saj. Edhe tani në moshë të shtyrë, Genc Ballanca vazhdon të interesohet paseshtur për mbarëvajtjen e shoqatës...*

**K**ryesia e OBVL i shpreh urimet më të përzemërta për jetëgjatësi dhe lumturi të pamatë në gjirin e familjes së tij të mrekullueshme veteranit Genc Ballanca në ditëlindjen e tij të 97-të.

I lindur në 7 Mars të vitit 1929. Genc Ballanca ishte djali i një familje të njohur për atdhetari me origjinë nga Dibra e Madhe. Babai i tij Xhevdet Ballanca, ka qenë oficer, që kishte studiuar në Akademitë Ushtarake të Romës e Stambollit, dhe gjithë aftësitë e tij i vuri në shërbim të popullit dhe Atdheut. Duke qenë antifashist, ai përkrahu dhe u lidh me figura të shquara të historisë tonë si Abaz Kupi, Nako Spiru, Iliaz Reka etj. Ai i priti me armë në dorë pushtuesi italianë më 7 Prill të vitit 1939 dhe vazhdoi luftën me forcat nacionaliste. Janë këto vlera, për të cilat ky atdhetar i shquar është dekoruar me rastin e 45 vjetorit të ndarjes nga jeta, nga Presidenti i Republikës, për veprimtari patriotike dhe është shpallur "Qytetar Nderi" i Durrësit me vendimin e datës 20.03.2011. Gjyshi i Gencit, Baftjari është ai që vrau një ditë pazari Mehmet Pashën. Nëna e tij vinte nga familja e njohur atdhetare e Dollive në Kavajë dhe me Xhevdetin patën tetë fëmijë të mrekullueshëm.

I rritur në një mjedis të tillë, edhe Genci, sido që mjaft i ri dhe ende pa e përfunduar plotësisht shkollën e mesme por me ide të qarta për lirinë, u rresh-



tua me shokët partizanë; fillimisht në Grupin e II - të të Çetës së Pezës, ku më pas, falë guximit dhe trimërisë së treguar në luftime ju ngarkua detyra e Përgjegjësit të Rinisë të batalionit, dhe në vazhdim, porsa u formua Brigada e IV - të Sulmuese, ju besua detyra e zëvendës intendentit të saj.

I mençur dhe me inisiativë, ai kudo që u caktua i kreu detyrat e ngarkuara

me nder. U shqua në luftimet e zhvilluara deri në largimin e plotë të armikut dhe pas çlirimit të vendit u emërua në Komandën e Përgjithshme, ku pa nga afër përpjekjet e paseshtura për rritjen, fuqizimin dhe modernizimin e ushtrisë tonë. Por në vitin 1948, duke parë nevojën që kishte për të familja e tij, ai vendos të kthehet në qytetin e Durrësit ku kryen detyra të ndryshme dhe të rëndë-

sishme në ndërmarrje të sapokrijuara.

Kudo që punoi u dallua për marrëdhënie korrekte me vartësit dhe shokët, për përkushtim e thjeshtësi, gjë që edhe pasi doli në pension i dha të drejtën të nderohet e respektohet nga të gjithë. Këtë e tregojnë mesë miri edhe dekoratat e shumta që i janë akorduar ndër vite.

Duke i mbetur besnik idealeve të pastra, duke mos u pajtuar për asnjë çast me krimet e kryera nga Partia - shtet dhe duke parë se në çfarë mjerimi e varfërie po e çonin Shqipërinë sloganet demagogjike, ai si kuadër me vizion perëndimor, përkrahu nga të parët lëvizjen demokratike, dhe së bashku me shokë të tjerë, si gjeneral Ernest Jakova, Zenel Bardhi, Idriz Hoxha, Eqerem Kuka, Osman Xhindoli etj. u bashkuan me organizatën e Bashkuar të Veteranëve të LANÇ - OBVL dhe për një kohë të gjatë, kreu me sukses të plotë, detyrën e Kryetarit të Degës për Durrësin, ku u tregua i pa lodhur dhe përherë i përkushtuar. Dega e OBVL - së në Durrës, nën drejtimin e tij u dallua për organizimin e shumë veprimtarive dhe shtimin e radhëve të saj. Edhe tani në moshë të shtyrë, Genc Ballanca vazhdon të interesohet paseshtur për mbarëvajtjen e shoqatës. Kryesia e OBVL i uron atij jetë të gjatë dhe të lumtur me familjen e tij të shtrenjtë.

## NDERIMI

## TATJANA PARLLAKU ÇARKAXHIU: MIRËNJOHJA E KRYESISË SË OBVL PËR BESNIK KABËN

- *Kryetari i Këshillit të të Urtëve të OBVL, 90 - vjeçari Shuaip Methasani, mishërues i vlerave më të mira njerëzore dhe intelektuale (simbol i urtësisë dhe mençurisë dibrane), ndër të tjera tha se "Besnik Kaba, ndonësi i biri një luftëtari të lirisë që kishte qenë pas çlirimit edhe funksionar i Kryqit të Kuq Dibër (1947-1949) dhe kryetar i këshillit Popullor të fshatit Pilafe Dibër për 11 vjet (1949-1961), pas internimit të tij në Saver - Lushnjë në vitin 1961 për motive politike, e përballoi me dinjitet edhe këtë sfidë.*

**M**ë 31 Mars 2026, Kryesia e OBVL vlerësoi me Certifikatë Mirënjohje Z. Besnik Musli Kaba në 89 - vjetorin e ditëlindjes së tij.

Në një takim festiv të organizuar me këtë rast nga Kryesia e OBVL, kryetarja e organizatës tonë Znj. Tatjana Parllaku-Çarkaxhiu, ndër të tjera tha se vlerësonte z. Besnik Kaba, për kontributin si pasardhës i veteranëve të LANÇ në evidentimin dhe promovimin e historisë së ndritur të kombit shqiptar në shekuj, duke ecur në gjurmët e babait të tij Musli Bajram Kaba - ish partizani që luftoi me armë në dorë për

çlirimin e atdheut nga okupatori nazifashist në radhët e Çetës partizane të Dibrës, Batalionin "Reshit Çollaku" dhe në Brigadën e 18-S partizane.

"OBVL, veteranët dhe pasardhësit e tyre, siç është edhe z. Besnik Kaba, anëtarë të kësaj organizate ndjehen më krenarë se kurrë me historinë e saj të suksesshme 32 vjeçare dhe angazhohen për të ecur në shembullin e themeluesve, që organizata jonë të vazhdojë të funksionojë si mbrojtëse e flaktë e vlerave të lirisë. Mbrojtja, propagandimi, ruajtja, mbajtja gjallë e vlerave të historisë sonë kombëtare, e veçanërisht atyre të LANÇ-it, dhe



transmetimi i tyre te brezat pasardhës është dhe mbetet qëllimi themelor i OBVL-së -tha ndër të tjera kryetarja Parllaku Çarkaxhiu.

Kryetari i Këshillit të të Urtëve të OBVL, 90 - vjeçari Shuaip Methasani, mishërues i vlerave më të mira njerëzore dhe intelektuale (simbol i urtësisë dhe mençurisë dibrane), ndër të tjera tha se "Besnik Kaba, ndonësi i biri një luftëtari të lirisë që kishte qenë pas çlirimit edhe funksionar i Kryqit të Kuq Dibër (1947-1949) dhe kryetar i këshillit Popullor të fshatit Pilafe Dibër

për 11 vjet (1949-1961), pas internimit të tij në Saver - Lushnjë në vitin 1961 për motive politike, e përballoi me dinjitet edhe këtë sfidë.

I diplomuar në Shkollën e Mesme të Ndërtimit Lushnje, Besniku punoi me ndershmëri, jo vetëm në punët e rënda në ndërtim, por edhe si mjeshtër perimesh. Me ndërrimin e sistemit në vitin 1991, Besnik Kaba u zgjodh Kryetar i Këshillit të Bashkuar Pluralist për fshatrat Saver-Gjazë, Rapër, detyrë të cilën edhe në kushtet e krizës së rëndë që po kalonte vendi ynë e përballoi me dinjitet.

## ESSE

*Komisari im, Begator Kozeli*

# Mishërim i pjekurisë, diturisë dhe dashurisë ndaj studentëve ushtarakë

Vasil Premçi

Në vitet e rinisë, rrethanat e jetës më nxorrën në një shteg të palakmuar: vazhdimin e Shkollës së Bashkuar Ushtarake, ndonëse e them qysh në krye të herës, nuk ishte shkolla më e pëlqyeshme për mua. Sot që rëndis këtë radhë kujtimesh për ato vite të para gjysmë shekulli, kisha shkuar shpesh-herë në mendje figurën e oficerit. Në vizionin tim, ata oficerë që dolën nga lufta nacionalçlirimtare dhe vazhduan studimet në akademitë e vendeve ish-socialiste, bënë një figurë të hijshme kur shfaqeshin në qytetet tona. Uniformat e tyre ishin prej një stofi të shtrenjtë ngjyrë ulliri, por edhe kishin mësuar të ecnin me gjymtyrët dhe trupin plot harmoni dhe hijeshi. Apo nuk u ndriçonin edhe yjet e gradave në spaleta! Nuk më hiqet nga mendja një fotografi e vjehrrit tim, të sapo kthyer nga këto studime me uniformën e tij prej stofi të shtrenjtë.

Pas prishjes me Traktatin e Varshavës, apo gjatë lulëzimit të miqësisë Shqipëri-Kinë, mbisunduan uniformat prej doku, që dukeshin sikur sapo ishin nxjerrë nga lavatriçja. Mbi të gjitha, uniformat ushtarake nuk mbanin më gradat, aq sa shpeshherë, kur kalonin oficerët në ambientet publike, dëgjoheshin zëra që pëshpërisnin: “Janë bërë si këmbët e dhisë! Nuk duket cili është oficeri dhe cili ushtari!”

Bash në këtë periudhë, pra në shtator të vitit 1973, nisa studimet në Shkollën e Bashkuar Ushtarake, në Tiranë. Ishte një zgjedhje kundër dëshirës time, por në kushtet ekonomike të familjes sime, me katër vëllezër dhe një motër, ajo ishte e vetmja alternativë, njësoj si një të urituri që i vënë përpara një pjatë supe të mbytur me kripë, të cilën ai duhet ta hajë ose ndryshe do të mbetet me gisht në gojë. Janë të paharrueshme emocionet e ditëve të para në ambientet e asaj shkolle!

Ndonëse ishte mesi i muajit shtator, dukej sikur ditët e verës kishin lëshuar rrënjë dhe nuk donin të largoheshin. Papritur mbrëmjen e parë brënda atyre mureve, nisi të bjerë një shi i butë, pikat e të cilit nën dritat e neoneve të sheshit të rreshtimit, dukeshin si një re mushkonjash. Mos edhe natyra po lotonte së bashku me ne?

Në fjetoren në të cilën qëndronin studentët ushtarakë të sapo ardhur, dikush nga oficerët kujdestarë mbërriti me shpejtësi në mes të fjetores dhe lajmëroi me zë të lartë:

— Do të rreshtoheni para fjetores në sheshin e rreshtimit sepse do t’ju përshëndesë Drejtori i Drejtorisë Politike, shoku Hito Çakol!

Të gjithë ne rishtarët dolëm përpara fjetores në sheshin e madh të shkollës, në pritje të eprorit të lartë.

Papritur, përballë nesh u shfaq silueta e një ushtaraku trupshkurtër dhe të ngjeshur me kapelen e rrasur deri mbi ballë. Edhe ai po lagej nga shiu. Edhe nga fytyra e tij zbrisnin rreketë e shiut, por ai as që donte t’ia dinte. Me një zë të lartë, sikur të kishte përballë mijëra njerëz, nisi fjalën e mirëseardhjes:

— Lexoj në sytë e disa prej jush një mërzi dhe trishtim, shkakun e të cilit e kuptoj. Ju ndiheni të fyer sepse kujtoni shumë nga shoqet dhe shokët e klasës së shkollës së mesme që do të ulen në bankat e fakulteteve dhe pas disa vitesh do të dalin inxhinierë, profesorë dhe doktorë apo ku di unë çfarë tjetër. Kurse ju do të dilni oficerë, apo jo! E pra, ta dini një herë e mirë dhe mbajeni mend për të gjithë jetën! Ju do të jeni oficerë, komandantë dhe komisarë, që në rast lufte do t’i komandoni këta inxhinierë, profesorë dhe doktorë, sepse çështja e mbrojtjes së atdheut është një çështje e të gjithë popullit! Mirë se erdhët në gjirin e ushtrisë tonë popullore! Pastaj ai u kthye nga shoqëruarit dhe u drejtua nga ndërtesa e komandës së shkollës.

Shpejt u ambientuam me jetën ushtarake, orarin, leksionet dhe stërvitjet e përditshme. Tashmë kishim hyrë në brazdat e zbatimit të kërkesave të rregullores.

Një mbrëmje, afër përfundimit të orarit të studimit, u hap qetësisht dera e kabinetit të togës së vitit të parë të xhenios. Studenti i parë që vuri re hyrjen e një oficeri me trup mesatar dhe me një fytyrë simpatike dha komandën:

— Çohu! Gatitu! Qendër ndero! Shoku komisar i shkollës, efektiv i togës së xhenios vijon orarin e studimit!

Ishte hera e parë që e shihnim nga afër, ish-partizanin riosh, me kokën e lidhur me shaminë gjak të kuqe, të batalionit “Hakmarrja”, komisar Begator Kozelin. Ishte 47 vjeç dhe në tëmtha kishin filluar ti shfaqeshin thinja e arta, por ishte flokë dendur dhe eme onde që e hijshonin fytyrën e tij me tipare të imta. Qysh në fjalët e para na dha ndjesinë se mund të bisedonim me atë si me një prind, apo një vëlla më të madh. Me pak fjalë na kumtoi qëllimin e ardhjes: “Dua të bisedojmë si prindi me djalin, si vëllai më i madh me vëllain më të vogël. Tani ju jeni anëtarët më të rinj të familjes tonë të madhe, ku mbisundon parimi i luftës së shenjtë partizane: Të gjithë për një – një për të gjithë!”

Duket se nuk ishte nga ata kadro ushtarakë që kishte nevojë të ngrinte zerin për të fituar autoritet te vartësit, por ashtu i përqendruar dhe duke vështruar me qetësi dhe vëmendje bashkëbiseduesin, të ngjallte një respekt të veçantë. Jeta kulturore-artistike dhe veprimtaritë sportive morën një gjallëri dhe hov të paparë në Shkollën e Bashkuar Ushtarake. Pas gjithë këtyre veprimtarive nënkuptohej interesimi i drejtpërdrejtë i komisar Begator

Kozelit. Sa energji dhe përkushtim dëshmonte ai në auditorët e shkollës, poligonët dhe fushat e stërvitjes, në spartakiadat sportive dhe skenat e shfaqjeve artistike! Njëherësh formësoi në memorien tonë edhe modelin e admirueshëm të kuadrit të ardhshëm të ushtrisë popullore, me vizione të qarta, njohuri të thella ushtarake dhe mbështetës i vendosur i talenteve të reja në radhët e studentëve të Shkollës së Bashkuar Ushtarake, të cilën ai e quante me krenari “Fidanishtja e gjelbër me kadro e ushtrisë”. Gjatë asaj periudhe botova disa reportazhe nga stërvitjet tona si dhe ndonjë tregim artistik në organin politiko-ushtarak të shkollës, “Buletini”. Këto krijime ishin cicërimat e mia të para në fushën e letërsisë. Po atë vit botova në Tipografinë ushtarake si një libër më vete edhe një novelë të gjatë.

Me rastin e 30-vjetorit të krijimit të ushtrisë popullore u shpall nga Lidhja e shkrimtarëve dhe artistëve të Shqipërisë dhe Ministria e Mbrojtjes konkursi kombëtar në fushën e letërsisë dhe arteve të bukura; juria vlerësoi me çmimin inkurajues vëllimin tim me tregime dhe novela “Hije që vdesin”.

Ku mësoi për këtë sukses komisar Begator Kozeli, në takimin e ditës së hënë me studentët ushtarakë dhe trupën mësimore, përveç detyrave dhe porosive të zakonshme, kumtoi si një ngjarje të rëndësishme për shkollën vlerësimin e vëllimit tim me tregime dhe novela. Dhe natyrisht, kërkoi të njihej me mua. Sipas rregullores, komandanti i batalionit iu përgjigj se “Vasil Premçi nuk ndodhet në sallë sepse ka radhën e pastrimit të banjave.”

Një përgjigje e cila shkaktoi edhe të qeshura. (Diçka të tillë: D.m.th, talenti i spikatur tani duhet të mësojë të pastroi edhe banjat.)

Pas njoftimit dhe mbërritjes në sallën e kinemasë, dëgjova fjalët përgëzuese të komisar Begator Kozelit:

— Ja pra, shkolla jonë ushtarake nuk nxjerr vetëm sportistë të shkëlqyer në futboll, volejball, basketboll, qitje, mundje dhe atletikë, por edhe shkrimtarë në fushën e artit dhe të letërsisë. Çmimi juaj për vëllimin me novela dhe tregime është dallëndyshja e parë e talenteve të shkollës sonë në fushën e letërsisë.

Ai tregoi një kujdes të veçantë kur më ftoi një pasdite në një takim miqësor.

— Me siguri ju do të dëshironit të ndiqni veprimtaritë artistike dhe kulturore që organizohen nga Lidhja e shkrimtarëve si dhe ato në Pallatin e Madh të Kulturës, — më tha ai. — Do të keni mbështetjen time, — vijoi duke më zgjatur një fletë-leje të vulosur me vulën e Komandës së Shkollës së Bashkuar Ushtarake dhe të firmosur nga vetë ai. Fletë-leja ishte e përhershme deri në përfundimin e studimeve dhe



më mundësonte të dilja gjatë ditëve të javës nga ora 16 deri në orën 20.

lexuesin civil, një fletë-leje e tillë mund të dukej e thjeshtë, por për një student ushtarak ajo kishte një vlerë të jashtëzakonshme.

Nëpërmjet saj, ndiqja pasionin tim për letërsinë, duke ruajtur përgjegjësitë ndaj shkollës dhe ushtrisë, dhe përjetoja njëkohësisht atmosferën e kohës dhe lidhjen e shkollës me botën e artit dhe të kulturës.

Ajo fletë-leje nuk ishte thjesht një leje administrative, por ura ime drejt botës së krijimtarisë, një shteg që më mësoi se përkushtimi dhe pasioni mund të bashkëjetojnë, edhe kur disiplinat dhe rregullat duket se kufizojnë lirinë e mendimit. Ajo më ndihmoi të kuptoja se arti dhe detyra mund të ecin dorë për dorë, dhe se çdo sukses, madje edhe më i vogli, ka vlerën e tij të veçantë në rrugën e formimit tonë si individë dhe qytetarë.

Sa herë sjell ndër mend figurën e komisarit të Shkollës së Bashkuar Ushtarake, Komisarit tim, Begator Kozelit, ashtu si në këtë vit përkujtimor, kujtoj edhe fjalët e Nënë Terezës: “Jo të gjithë mund të bëjnë gjëra të mëdha, por mund të bëjnë gjëra të vogla me dashuri të madhe”.

## NDERIMI

# “QYETAR NDERI I PUKËS”, TITULL I MERITUAR PËR HUMANISTIN E FILANTROPIN E SHQUAR GJON BERISHA

**PROF. XHEMAL MEÇI  
STUDIUES, “MJESHTËR I MADH”**

Këshilli i Bashkisë Pukë i ka akorduar titullin “Qyetar Nderi” humanistit dhe filantropit të shquar Gjon Berisha. Nderimi për Gjon Berishën që aq bindës sa e tregoi me një oratori poetike kolegu e shoku i tij zotni Gjergj Dedë Thaçi, i cili tha se në radhë të parë është mirënjohje dhe respekt për gjithë kontributin e tij. Në rastin e 70 - vjetorit të lindjes dhe të veprimtarisë jetësore, është një nderim i madh jo vetëm për Gjonin dhe familjen Berisha, por parasëgjithash, është mirënjohje, respekt dhe nderim për Pukën, Gjakoven, Shqipërinë dhe për Kosovën, të cilave Gjoni ua dhuroj dashurinë, djer-sen, mundin, lotët dhe gjakun. Prandaj edhe Bashkia Pukë e nderoi duke e shpallur “Qytetar Nderi” të Pukës me 27 mars 2026.

Me t’ju dorëzuar vendimi i Këshillit të Bashkisë Pukë, auditori i sallës 450 vendesh së koncerteve, u ngrit furishëm në këmbë me brohoritje e duartrokitje të zgjatura, bashkë me thirrje të fuqishme vllazërore të gëzueshme, sa dukej si të kishte rënë tërmet. Këngët, vallet, recitimet s’kishin të sosur sa të kujtonin vargjet e këngës së kompozitorit të shquar Pjetër Gacit, “se ç’po gëzon Malësia/ Krenarija jonë”.

Fran Pali, mjeshtër i talentuar, i cili i dha Pukës e gjithë Shqipërisë Violinën e Parë shqiptare ka argumentuar se Gjon Zef Berisha i ka rrënjët në Rajcë të Berishës së Pukës. Ai tregoi faktin se ky është bashkëvendës në 5 brezë me Gjon Zef Berishën. Fill mbas tij Fran Vuka, regjizor e poet recitoi poezinë e sapo krijuar “Mirëseerdhe Gjon Berisha, në Pukën tande plot me pisha...”

## “DHURATAT” E CCMUARA PËR GJON BERISHËN

Unë e takova mes dhjetra pukasve për t’i dhuruar Botimin me këngët e rapsodit të mirënjohur Prendush Gega i pagëzuar si “Poeti i Malësisë, Homerit i Maleve.

- Po unë tha? Dhe tregoi duart bosh. - Ju besoj të leni gjurmët e kësaj dite, në Pukën tonë me memorialin e 110-vjetorit të Pukës këtu. Dëgjo i vemendshëm dhe buzëqeshi duke tundur kryet me mirëdashje. Po kështu edhe oratorit cicëronit për jetën e bëmat e Gjon Zef Berishës, Gjergj Dedë Thaçit i dhurova plot dashamirësi botimin “Dëshmorët e Atdheut” të Pukës, ku jepen heroizmat e malësorve të Pukës në luftën e përgjakshme me pushtuesit serbo-malazez, që nga Plavë e Guci deri në Vaspas e Shkodër.

Do të ishte me interes që të ribotohej në afro 150 kopje e t’u dhuroheshin në Kosovë familjeve të Dëshmorëve, shkollave e institucioneve shkencore, muzeve etj., ku të dëgjonin se sa guxim e trimëri treguan Pukë e Mirditë në luftën me pushtuesit, “se s’janë mësue me u korit, po janë mësue pushkë me qitë”.

Le të shpresojmë në këto sugjerime për kujtime, siç ka veprue Z.Dedë Maluta me përmendoren e Nënë Terezës, Z.Fran Gjoka Daka me shtatorën e Migjenit me Lulin e Vocërr, siç po vepron tani i nderuari Z.Kadri Morina me rikonstruksionin e Shkollës Muze Migjeni (sado që punimet nuk bëhen pa ndërprerje të gjata nga fakti se edhe Bashkia nuk ushtron kërkesë llogaridhënie).

## KUSH ËSHTË GJON BERISHA

Gjon Berisha, ka lindur me 22 shkurt



1956 në fshatin Orize, Gjakovë, ngjitur me fshatin Meje të Gjakovës, aty ku me 27 prill 1999, ka ndodhur masakra më e madhe serbe në Kosovë. Gjithsesi ai e pohon origjinën nga fshati Rajcë i Berishës, Pukë.

Forcat kriminale serbe në Meje të Gjakovës vranë 380 civil shqiptar, në mesin e të cilëve fëmijë, gra dhe të moshuar, masakër që Gjon Zef Berisha e përjetoi me trishtim e urrejtje.

Gjoni shkollën fillore e 8 vjeçare e kreu në fshatin Greikoc të Gjakovës.

Babai i Gjoni, Zef Berisha, duke qenë djalë i vetëm i një burri të shquar Malsor e Pukjan, Mushak Hajdari, ishte i pëndjekur nga regjimi i Serbisë dhe ishJugosllavisë, prandaj arratiset në Shqipërinë e Enver Hoxhës dhe si shumë shqiptarë të tjerë nga Kosova, të cilët arratiseshin ilegalisht në Shqipëri, regjimi komunist e dergoi për afër 10 vjet në kampet e internimit.

Gjoni fëmijërinë e kaloi me gjyshin dhe nënën, në skamje dhe varfëri, si dhe i vëzhguar nga pushteti dhe regjimi policor serbo-jugosllav.

I gjendur në një situatë të vështirë për ekzistencë, në moshën 15 vjeçare, Gjoni largohet nga Kosova dhe vendoset për të punuar në Austri, në punë të rëndë dhe të frikëshme për moshën e tij të njomë, si varrhapës në varrezat në periferi të Vjenës.

Nga Austria ai largohet me punë dhe qendrim në Gjermani dhe për shumë vite nuk mundi të kthehej në Kosovë, sepse nuk donte ta kryente shërbimin ushtarak në armatën serbo-jugosllave sepse mund të arrestohej, ose të vritej si shumë ushtarë shqiptarë Kosovë, të cilët i kthenin në familje si “të vetëvrarë”, mbyllur hermetikisht në arkivole.

Nga Gjermania kujdesej për mirëqenjen e familjes dhe të afërmeve të tij në Gjakovë, pasi që u punësua në portin e madh të Hamburgut. Më pastaj u mor me gastronomi kurse më vonë e hapi kompaninë e tij imobilare dhe të ndertimtarisë, duke arritë të kishte mbi 250 puntorë nga Gjermania, Polonia, Kosova, Shqipëria dhe Maqedonia. Me forcimin e gjendjes ekonomike humanisti dhe filantropi Gjon Berisha filloi mbështetjen e familjarëve, miqëve, nevojtarëve, por edhe të segmenteve të arsimit, kultures, politikës, shëndetësisë dhe informimit në Shqipëri dhe Kosovë.

Me ndërhyrjen brutale të Serbisë

në Kosovë duke i hequr autonominë politik-kulturorë, në vitin 1989, duke larguar punëtorët shqiptar nga puna, nga shëndetësia, arsimi, policia dhe ekonomia, por Gjoni ishte në mbështetjen e zhvillimeve në Kosovë por edhe të gjendjes së rëndë të Shqipërisë së viteve 1990.



Gjerqj Dedë Thaçi, Gjon Gjoni, Gjon Zef Berisha, Xhemal Meçi, Rrok Dodaj

Ai mori kontakte me pothuaj të gjithë liderët politik të Shqipërisë, Kosovës, Maqedonisë dhe Malit të Zi, si Pjetër Arbërori, Sali Berisha, Edi Rama, Fatos Nano, Ilir Meta, Zef Bushati, Xhezair Zaganjori, Ylli Pepo nga RTSH, pastaj me Akademinë e Shkencave dhe Artyeve të Shqipërisë, të cilët i takonte në Tiranë, apo i priste në vilën e tij të pagëzuar “Villa Berisha Albania”, në Hamburg të Gjermanisë, e cila ishte strehe apo si një “ambasadë” shqiptare e qindra politikanëve, veprimtarëve, intelektualëve dhe misionarëve të çështjes kombëtare si Ibrahim Rugova, Fehmi Agani, Bujar Bukoshi, Isa Mustafa, Anton Qetta, Mark Krasniqi, Gjergj Dedaj, Lazer Krasniqi, vëllëzerit altruist e atdhetar Simon e Mikel Kuzhnini, Hoxhë Idriz Kokrruki, Ipeshkvët Mark Sopi e Don Lush Gjergji, pa dallime dhe ngjyrimet politike, ideologjike apo fetare.

Me rastin e fillimit të luftës së armatosur në Kosovë, ndërmjet UÇK dhe forcave serbe të Millosheviçit, 1998/1999, me çrast vriteshin mijëra shqiptarë të Kosovës, siç dihet ndodhi në vendlindjen e Gjoni edhe masakra e madhe në Meje të Gjakovës në pran-

veren e vitit të përgjakshëm 1999, kur filloi terrori, vrasjet dhe spastrimi i dhunshëm etnik i qindra mijëra kosovarëve, të cilët ia mësyen Maqedonisë dhe Shqipërisë, ku ua hapen zemrat dhe shtëpitë për vëllëzërit nga Kosova. Gjoni erdhi në Shqipëri, duke ndihmuar ata që kishin nevojë financiare, duke përfshirë edhe shumë pjesëtar të UÇK-së.

Me të përfunduar lufta Gjoni kthehet në Kosovë, për të ndihmuar kalimin e pasojave të luftës heroike të popullit të Kosovës.

Për Trupat Mbrojtëse të Kosovës, TMK, Gjoni organizoj bashkatdhetarët në Hamburg për të ndihmuar TMK me veshëmbathje dhe pajisje tjera të nevojshme. Ndër vlerat dhe virtytet unike dhe të veçante është se Gjon Berisha kurrë nuk ka kërkuar t’i kthehen në asnjë mënyrë ato ndihma të shumta që ka dhënë, madje as t’i përmenden, duke mos kërkuar shpërbllim dhe asnjë privilegj për kontributin e tij historik. Janë disa miq dhe njerzë të tjerë si Gjergj Dedë Thaçi i Bugjonit të cilët sëpaku nuk e kanë harrur kontributin e tij kolosal, duke e nderuar me ndonjë falenderim, mirënjohje dhe respekt për ta provokuar heshtjen dhe modestinë e tij prej virtytit të Malsorit Pukjanë, i cili ndjehet shumë mirë kur të tjerët ndjehen mire. Me interes ishte dokumentari për Gjon Zef Berishën

nga Nikolin Deda.

Megjithatë janë shume institucione shtetërore të cilat e kanë nderuar personalitetin dhe kontributin e Pukjanit Gjon Zef Berisha, me titullin: AMBASADOR NDERI I REPUBLIKËS SË KOSOVËS, në vitin 2019 me vendim të Presidentit të Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi. Gjon Berisha ishte nderuar me MEDALJEN E PAVARËSISË SË KOSOVËS, më 2018, me rastin e 10 vjetorit të shpalljes së Pavarësisë, për kontributin e dhënë për Lirinë dhe Pavarësinë e Kosovës.

Ambasadori i Nderit i Kosovës, Gjon Berisha ishte nderuar edhe nga Presidenca e Republikës së Shqipërisë, Ushtria Çlirimtare e Kosovës, Trupat Mbrojtëse të Kosovës, Shoqata DEA e Artistëve Shqiptar të Kroacisë, është nderuar edhe me Mirënjohjen e Partisë Liberale të Kosovës “Marije Shllaku” të heroinës Shkodrane e pushkatuar në Kosovë, në vitin 1946, për aktivitetin e krijimit të Shqipërisë Etnike; si dhe një mori fletëfalenderimesh dhe mirënjohje të tjera për kontributin e tij atdhetar, historik dhe humanitar në dekadat më të vështira të çështjes kombëtare dhe të Kosovës martire.